



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 704 Akti

Nr. 811 Vendimi
Tiranë, më 8.11.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Alma Faskaj	Anëtare

në prani të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Mevi Dibra, në datën 6.11.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati 0 (*underground*), zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Eranda Laze**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, aktualisht prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, dëgjoi subjektin në seancë dëgjimore, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Eranda Laze, është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për shkak të funksionit të saj si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, aktualisht prokurore pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, znj. Eranda Laze i është nënshtruar procesit të

rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.12.2020 me trupin gjykues të përbërë nga komisioneret Alma Faskaj, Pamela Qirko dhe Xhensila Pine (relatore).

3. Komisioni administroi nga institucionet ndihmëse të procesit raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK, ish-DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

4. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, filloi hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesuese komisioneren Pamela Qirko dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues me vendimin nr. 2 vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit, znj. Eranda Laze, bazuar në tri kriteret e rivlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t' u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave e thirrjen e dëshmitarëve dhe afatin e ushtrimit të tyre.

6. Në datën 14.10.2024, subjektit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit për sjelljen e provave dhe shpjegimeve për të provuar të kundërtën e barrës së provës. Subjekti me kërkesën e datës 25.10.2024 kërkoi kohë shtesë për të sjellë prova dhe shpjegime.

6.1 Me vendimin nr. 3, datë 28.10.2024, Komisioni vendosi të pranojë kërkesën e subjektit, duke e shtyrë afatin deri në datën 4.11.2024.

7. Me vendimin nr. 4 të datës 4. 11.2024, trupi gjykues vendosi të thërrasë në seancë dëgjimore subjektin e rivlerësimit në datën 6.11.2024, në orën 10:00.

I. SEANCA DËGJIMORE

8. Në datën 6.11.2024, ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe vëzhguesit ndërkombëtar, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Seanca dëgjimore u ndërpre për të vijuar me shpalljen e vendimit të trupit gjykues në datën 8.11.2024, në orën 10:00.

8.1 Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV NGA KOMISIONI

9. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Referuar vendimit nr. 2/20171 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

10. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt të rivlerësimit ka konstatuar:

➤ *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*

- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklaram të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

11. Komisioni kreu një hetim të pavarur bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në vendimet nr. 2 dhe nr. 17 të vitit 2017 të Gjykatës Kushtetuese, duke kryer një sërë veprimesh verifikuese hetimore për verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklaramit të bërë nga ky subjekt, të dhënave të pasqyruara dhe përfundimeve të nxjerra nga kontrolli i kryer nga ILDKPKI-ja, bazuar në dokumentacionin dhe provat shkresore, administruar në dosje, nga ku ka rezultuar si vijon:

1. Apartament banimi me sipërfaqe 181.2 m², në *, Tiranë, vlera 81,284 euro¹**

1.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: dy apartamente banimi, të bashkuar në një, në bashkëpronësi me bashkëshortin, me sipërfaqe totale 181.2 m², ndodhur në ***, Tiranë. Vlera: 81,284 euro.

1.2 Burim krijimi i deklaruar nga bashkëshorti i subjektit janë: (i) të ardhurat nga emigracioni; (ii) aktiviteti privat dhe publik i ushtruar në harkun kohor 2004 – 2008, të deklaruara në kohë, në shumën 40,000 euro; (iii) kredia e marrë për këtë qëllim.

Faktet e rezultuara nga hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

1.3 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në DIPP-në e vitit 2010. Bashkëshorti si person i lidhur ka deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2008, duke deklaruar konkretisht: një apartament me sipërfaqe 80 m² në lagjen “****”, Vlorë (kontratë premtim shitjeje, datë 9.4.2008, nr. *** rep., nr. *** kol., me vlerë 52,000 euro, një shtëpi private e përbërë nga dy dhoma e një kuzhinë, me sipërfaqe trualli 200 m², ndodhur në Durrës, në bashkëpronësi, depozitë bankare pranë NBG Bank, Vlorë, në shumën 10,000 euro, si dhe kursime 30,000 euro).

1.4 Nga hetimi ka rezultuar e provuar se është nënshkruar një kontratë për prenotim shitjeje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.12.2009, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe prenotuesit të apartamentit, z. E.L. Objekt kontrate ka qenë prenotimi për blerjen e dy apartamenteve model një plus një, me sipërfaqe 89 m² dhe tjetri apartament dy plus një, me sipërfaqe 114,2 m². Në këtë kontratë është parashikuar se prenotuesi quhet pronar i këtij apartamenti pasi të ketë shlyer vlerën e tij prej 81,284 euro me këto këste: kësti i parë në datën e sotme të nënshkrimit të kësaj kontrate, në shumën prej 40,000 euro; kësti i dytë prej 30,000 euro do të shlyhet në datën e lëvrimit të kredisë për të cilën ka aplikuar; kësti i fundit për shumën e mbetur do të shlyhet në momentin e dorëzimit të apartamentit të përfunduar. Me kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.12.2014, të lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe blerësit E.L, pala shitëse është pronare e: (i) një apartamenti të ndodhur në ***, Tiranë, z. k. ***, nr. pasurie ***, shkalla ***, kati ***, vol. ***, faqe ***, pallati nr. ***, siç rezulton nga certifikata e pronësisë e lëshuar

¹ Në dosjen e ILDKPKI-së, subjekti ka depozituar gjithashtu: (i) certifikatë për vërtetim pronësie, datë 4.2.2015, për apartament me sipërfaqe 80 m² dhe sipërfaqe 101.2 m², në emër të z. E.L dhe kartelat e pasurisë; (ii) kontratë kredie bankare nr. ***, datë 11.1.2010, nga NBG Bank në shumën 30,000 euro, me qëllim blerjen e një apartamenti në ***, Tiranë, komuna ***. Kredimarrës E.L dhe Eranda Laze dhe dorëzantës P.L, H.L, Xh.L dhe L.L; (iii) vërtetim nga NBG Bank, datë 24.1.2017, sipas të cilit Eranda Laze dhe E.L kanë të akorduar kredi në shumën 30.000 euro prej datës 15 janar 2010. Shuma e mbetur e kredisë në datën 24.1.2017 është 11,949 euro. Klienti paguan një kësht prej 380 euro, afati i përfundimit të kredisë është data 15.1.2020; (iv) vërtetim nga NBG Bank, datë 22.1.2015, ku citohet se në datën 19.1.2010 është kryer kalimi i shumës 29,100 euro sipas kushteve të protokollit të kredisë së marrë pranë NBG Bank; (v) Transferimi i shumës nga llogaria në emrin e E.L tek llogaria e “****” sh.p.k., me përshkrimin “Kësht apartamenti sipas kontratës nr. *** dhe kontratës së kredisë nr. ***”.

nga ZRPP Tiranë në datën 14.8.2013; (ii) një apartament i ndodhur në ***, Tiranë, z. k. ***, nr. pasurie ***, shkalla e ***, kati ***, apartamenti ***, i regjistruar në vol. ***, faqe ***, me sipërfaqe 80 m², siç rezulton edhe nga certifikata e pronësisë e lëshuar nga ZRPP Tiranë në datën 14.8.2013. Sipas kontratës së shitjes, pala blerëse i shet palës shitëse apartamentet e mësipërme kundrejt shumës 101.2 m² x 53.000 = 5,363,600 lekë; 80 m² x 53,000 lekë = 4,240,000 lekë.

1.5 Komisioni ka konstatuar mospërputhje të çmimit midis kontratës “Prenotim shitjeje” nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.12.2009, dhe kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.12.2014, lidhur midis palëve, shoqërisë “****” sh.p.k. dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. E.L. Referuar çmimit të kontratës prenotim shitjeje, çmimi i dy apartamenteve është në vlerën 81,284 euro, ndërsa referuar kontratës së shitjes çmimi në total i të dyja apartamenteve është 9,603,600 lekë. Mospërputhja e çmimit për këtë pasuri është në vlerën 1,477,848 lekë².

1.6 Subjekti në lidhje me mospërputhjen e çmimit të blerjes së apartamenteve në vlerën 1,477,848 lekë midis dy kontratave, në pyetësorin nr. 2, ndër të tjera, ka deklaruar se mospërputhja ka lindur për shkak se në kontratën “Prenotim shitjeje” çmimi është llogaritur në bazë të sipërfaqes totale prej 203,21 m², që ka përfshirë edhe sipërfaqet e përbashkëta, ndërsa në kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.12.2014, çmimi është përllogaritur në bazë të sipërfaqeve të shfrytëzueshme, përkatësisht 101 m² dhe 80 m², këto janë sipërfaqet e pasqyruara në të dyja certifikatat për vërtetim pronësie, të lëshuara në datën 14.8.2013 në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.

1.7 Komisioni, bazuar në këto prova, vlerësoi të analizojë si çmim të blerjes së këtyre dy apartamenteve vlerën 81,284 euro, e deklaruar në vijimësi nga subjekti.

1.8 Në bazë të të dhënave nga FSHU-ja, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, nuk rezulton të jetë abonent dhe të ketë kontratë të furnizimit me energji elektrike subjekti dhe personi i lidhur, bashkëshorti i saj.

1.9 Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë³ informon se për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin e saj nuk rezulton asnjë e dhënë për kontrata për shërbime me Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a.

1.10 Subjekti ka depozituar në Komision kontratën e furnizimit me energji elektrike nr. ***, me datë të vendosjes së matësit 17.2.2010, për objektin e ndodhur në ***, Tiranë, si dhe kontratën për shërbime me Ujësjiellës-Kanalizime nr. ***, datë 20.10.2023.

1.11 Komisioni ka kërkuar informacion edhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë lidhur me çështje penale të hetuara me shoqërinë “****” sh.p.k. apo ortakun(ët)/administratorin(ët)/përfaqësuesin e administratorit për raste të mundshme të konfliktit të interesit dhe nga përgjigjet⁴ nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë për subjektin e rivlerësimit.

1.12 Në përfundim të hetimit, subjektit i kaloi barra e provës, ku duket se:

- Ka mospërputhje në vlerën e apartamentit midis kontratës “Prenotim shitjeje”, datë 22.12.2009 dhe kontratës së shitjes, datë 12.12.2014.
- Nuk ka deklaruar kontratën “Prenotim shitjeje” nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.12.2009, në DPV-në e vitit 2009, as pagesën e kryer dhe detyrimin e mbetur.

² Mospërputhja e çmimit në vlerën 1,477,848 lekë rezulton si diferencë e çmimit të kontratës “Prenotim shitjeje” në vlerën 11,081,448 lekë (81,284-euro x 136,33) me çmimin në kontratën e shitjes në vlerën 9,603,600 lekë (5,363,600+ 4,240,000).

³ Shkresë nr. *** prot., datë 27.1.2021.

⁴ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.3.2024, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.13 Pas kalimit të barrës së provës, subjekti deklaron se dy apartamentet janë blerë sipas kontratës prenotim shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.12.2009. Në këtë kontratë është përcaktuar se prenotuesi quhej pronar pasi të kishte shlyer vlerën 81,284 euro. Një apartament është në sipërfaqen 89 m², ndërsa apartamenti tjetër ka një sipërfaqe prej 114.21 m². Në lidhje me termat e pagesës është përcaktuar se shuma 40,000 euro do të likuidohet me nënshkrimin e kontratës së prenotimit. Kësti i dytë prej 30,000 euro do të shlyhej në datën e lëvrimit të kredisë dhe kësti i fundit për shumën e mbetur do të shlyhej në momentin e dorëzimit të apartamentit të përfunduar.

1.14 Në datën 12.12.2014 është lidhur kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k në cilësinë e shitësit dhe bashkëshortit në cilësinë e blerësit. Apartamenti i parë, që sipas kontratës së prenotimit kishte sipërfaqe 89 m², referuar certifikatës së pronësisë është i regjistruar me nr. pasurie ****, sipërfaqe 80 m², ndërsa apartamenti i dytë, që sipas kontratës së porosisë kishte sipërfaqe 114.21 m², referuar certifikatës së pronësisë është i regjistruar me nr. pasurie ***, sipërfaqe 101.2 m². Pala shitëse deklaron se ia shet palës blerëse apartamentet me çmimin 53,000 lekë/m². Apartamenti me sipërfaqe 80 m² është në vlerën 4,240,000 lekë dhe apartamenti me sipërfaqe 101.2 m² është në vlerën 5,363,600 lekë. Në kontratën përfundimtare të shitblerjes nuk është përmendur sipërfaqja e përbashkët për këto dy apartamente.

1.15 Sipërfaqja e përbashkët për apartamentin e parë është 9 m², ndërsa për apartamentin e dytë është 13 m². Sipërfaqet e përbashkëta janë gjithsej 22 m². Kjo sipërfaqe nuk mund të jetë kosto e ndërtuesit, pasi ndërtuesi, përveç sipërfaqes së brendshme, shpërndan tek të gjithë blerësit, sipas koeficientit përkatës, sipërfaqet e përbashkëta. Në lidhje me mospërputhjen e vlerës, subjekti sqaron se ka ardhur vetëm si rrjedhojë e mospërfshirjes ose ndryshimit të sipërfaqeve të blera (nga 203.2 m² në 181.2 m²), ndërsa çmimi për metër katror i sipërfaqeve është i pandryshueshëm. Shuma që është paguar për blerjen e kësaj pasurie është 81,284 euro.

1.16 Nëse do të ishte paguar shuma prej 9,603,600 lekësh, nuk ka arsye logjike që të deklarohet një vlerë më e lartë e shumës së paguar; logjikë do të kishte nëse do të kishte ndodhur e kundërta.

1.17 Pra, mospërputhja e konstatuar nuk është rrjedhojë e një deklarimi fiktiv apo pasaktësie, por është rrjedhojë e përllëgaritjes vetëm e sipërfaqes së shfrytëzueshme të pasurisë së paluajtshme të blerë.

1.18 Në lidhje me mosdeklarimin e kontratës së prenotimit në DPV-në e vitit 2009, subjekti pranon që nuk e ka deklaruar në vitin 2009, por shpjegon se ka menduar që deklarimin në lidhje me këtë pasuri ta bënte në vitin 2010, kohë në të cilën do të disbursohej kredia dhe do të merrej në dorëzim apartamenti. Në DPV-në e vitit 2010 është deklaruar e gjithë vlera e apartamentit, kontrata e porosisë, si dhe arsyeja e deklarimit në këtë vit.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.19 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se rezultoni e provuar se çmimi i blerjes së kësaj pasurie rezulton të jetë 81,284 euro, vlerë kjo e pasqyruar në kontratën e prenotimit, me një fuqi provuese të detyrueshme, e deklaruar në DIPP-në e vitit 2010, në deklaratën *Vetting*, si dhe në pyetësorët e dërguar gjatë procesit të rivlerësimit.

1.20 Mosdeklarimi në DIPP-në e vitit 2009 të lidhjes së kontratës së porosisë (prenotimit) dhe pagesës së kryer e, për pasojë, detyrimi i mbetur, nuk përbën një pasaktësi, e cila mund të jetë penalizuese, sepse në DIPP-në e vitit 2010 është deklaruar nga subjekti e gjithë vlera e apartamentit, kontrata e porosisë, si dhe arsyeja e deklarimit në këtë vit, prandaj ky deklarim

është konsideruar si një korigjim i DIPP-së së vitit 2009, arsyetim ky që vjen në përputhje edhe me jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁵.

Analiza e burimit për blerjen e dy apartamenteve në zonën e Freskut, Tiranë

1.21 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim kursimin e krijuar në shumën 40,000 euro nga të ardhurat e realizuara nga emigracioni i bashkëshortit në vitet 1996 – 2004, nga aktiviteti privat dhe publik i bashkëshortit, i ushtruar në harkun kohor 2004 – 2008. Ky kursim është deklaruar në DIPP-në e vitit 2008.

1.22 Subjekti e deklaroi këtë pasuri për herë të parë në DIPP-në e vitit 2010, dy apartamente banimi të bashkuar në një, me sipërfaqe totale 203,21 m², pranë bar “****”, komuna ***, prenotuar sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.12.2009, paguar 40,000 euro + 30,000 euro, vlera totale e apartamentit 81,284 euro. Shënim i subjektit në DIPP-në e vitit 2010: “...Kontrata është nënshkruar nga bashkëshorti. E deklaroi këtë vit, pasi, edhe pse e regjistruar në vitin 2009, kontrata u mbyll pasi u lëvrua kredia bankare prej 30,000 euro në vitin 2010”.

1.23 Në seksionin e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, në deklaratën e po këtij viti, subjekti deklaroi: *Kontratë kredie nr. ***, datë 11.1.2010, me NBG Bank, afati 10-vjeçar, principali 30,000 euro, plus interesat.*

1.24 Referuar DIPP-së së subjektit në vitin 2008, bashkëshorti i subjektit deklaroi 40,000 euro (depozitë bankare plus kursime) me burim: (i) të ardhura nga emigracioni 1996 – 2004; (ii) të ardhura nga aktiviteti privat 2004 – 2006; (iii) të ardhura nga aktiviteti publik 2006 – 2008.

1.25 Në bazë të kontratës prenotim shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.12.2009, ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, është parashikuar që çmimi i blerjes së dy apartamenteve së bashku është 81,284 euro, që do të paguhej me këste dhe konkretisht: (i) kësti I është në datën e sotme të nënshkrimit të kësaj kontrate, në shumën 40,000 euro; (ii) kësti II, në shumën 30,000 euro, do të shlyhet në datën e lëvritimit të kredisë, për të cilën ka aplikuar; (iii) kësti i fundit për shumën e mbetur do të shlyhet në momentin e dorëzimit të apartamentit të përfunduar.

1.26 Në pyetësorin standard, subjekti në lidhje me blerjen e dy apartamenteve në ***, Tiranë, ka deklaruar se blerja e kësaj pasurie është financuar nga kursimet e bashkëshortit në shumën 40,000 euro, ekzistuese para martesë dhe të deklaruara rregullisht prej tij në deklaratën fillestare të pasurisë për vitin 2008, nga kredia në shumën prej 30,000 euro, marrë pranë ish-NBG Bank, dega Vlorë, si dhe nga shuma 10,000 euro, pjesë e kursimeve të krijuara gjatë viteve 2009 – 2010. Shuma prej 40,000 euro është paguar në dhjetor 2009, koha kur është lidhur kontrata e prenotim shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.12.2009. Në vijim të aprovimit të shumës 30,000 euro sipas kontratës së kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.1.2010, kjo kredi ka kaluar në muajin janar të vitit 2010 në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k.

1.27 Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me burimin e të ardhurave për shlyerjen e detyrimit të mbetur ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., gjatë hetimit ka deklaruar gjithashtu se shuma prej 10.000 euro është shlyer në fund të vitit 2010, kohë kur është dorëzuar apartamenti. “Shuma e mbetur rreth 1.200 euro është paguar në fund të vitit 2013. Për dy shumat e fundit të paguara është bërë vetëm një mandatarkëtim përmbledhës, nënshkruar nga bashkëshorti im dhe shoqëria “****” sh.p.k”, është shprehur subjekti.

1.28 Nga hetimi lidhur me burimin e të ardhurave për kryerjen e pagesës së shumës 40.000 euro në vitin 2009 ka rezultuar se:

⁵ Shihni vendimin nr. 33/2021 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

i) Në lidhje me të ardhurat nga emigracioni 1996 – 2004

1.29 Të ardhurat nga emigracioni për periudhën 1996 – 2004, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti dhe administruar nga Komisioni, janë kopje libreze pune për qytetarë të huaj me nr. *** regj., datë 1.12.1998, ku figuron punësimi në “****”, datë 10.12.1998 dhe “****” nga 6.3.2000 – 30.6.2004, kontratë individuale pune ndërmjet “****” dhe shtetasit E.L, datë 10.11.1998, kontratë pune me kohë të pjesshme ndërmjet “****” dhe shtetasit E.L, datë 10.11.1998, shkresë nga “****”, datë 10.12.1998, drejtuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në Itali, për punësimin e z. E.L me 34 orë në javë, rezident në ***, ***, vërtetim pagese mujore (*busta paga*) nga “****”, dhjetor 1998 – dhjetor 2001. Shuma totale rreth 9,000 euro, vërtetim pagese mujore (*busta paga*) nga “****”, me një shumë totale rreth 55,000 euro. Në të ardhurat ka dhe një shpërblim dëmi si pasojë e aksidentit në punë në shumën 14,037 euro (*liquidazione del danno*). Subjekti i ka depozituar këto dokumente në formën e kërkuar nga ligji.

Në tërësinë e dokumentacionit janë depozituar nga ana e subjektit:

- Dokumenti “Ekstrakt llogarie”, lëshuar nga INPS (Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore Itali), që dokumenton të ardhurat e përfituara prej shtetasit E.L nga punësimi në ndërmarrjet “****” dhe “****” përpara njohjes dhe martesës me subjektin, në harkun kohor 1.12.1998 – 30.6.2004, nga ku rezulton se shuma e të ardhurave është 66,655.27 euro.
- Dokumenti “Pasqyra e rimbursimit të shpenzimeve”, lëshuar nga INAIL (Instituti Kombëtar për Sigurimin kundër Fatkeqësive në Punë), që dokumenton likuidimin e bashkëshortit të subjektit për një aksident të ndodhur gjatë punës, nga ku rezulton se shuma e likuiduar për dëmin biologjik është në totalin 13,652.24 euro (5,838.55 euro + 6,587.10 euro + 1,226.59 euro).

1.30 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e administruar dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, kreu një analizë paraprake financiare, nga ku rezultoi paraprakisht se për periudhën dhjetor 1998 – qershor 2004 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka të ardhura në vlerën 80,308 euro, shpenzime jetike në vlerën 33,118 euro për një person dhe mundësia për të kursyer është në vlerën 47,190 euro. Me kursimet e kësaj periudhe bashkëshorti i subjektit ka krijuar 2 pasuri, konkretisht: (1) ka blerë një banesë në bashkëpronësi në qytetin e Durrësit, në vlerën 875,000 lekë, për pjesën e tij takuese; (2) një apartament banimi me sip. 80 m² në qytetin e Vlorës, në vlerën 52,000 euro, të analizuar si më poshtë:

2. Shtëpi private banimi në bashkëpronësi me vëllain, ndodhur në qytetin e Durrësit

2.1 Në deklaratën *Vetting*, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “*një shtëpi private banimi (e amortizuar), në bashkëpronësi me vëllain tim, e përbërë nga një dhomë, një kuzhinë, një sallon, me një ballkon, me tulla e tjegulla, mbi një truall me sipërfaqe 200 m², të ndodhur në Durrës (bashkëlidhur vërtetim nga dokumentet hipotekore të lëshuara në datën 9.3.2004 nga ZVRPP-ja Durrës)*”. Burim krijimi për këtë pasuri është deklaruar dhurata me vlerë 1,700,000 lekë nga babai i tij për dy fëmijët, me të ardhura të familjes, e cila ka emigruar që në vitin 1996 në Itali⁶. Kjo pasuri, e deklaruar në DIPP-në e vitit 2008, konfirmohet edhe nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, me të njëjtat të dhëna, sikundër është deklaruar edhe në deklaratën *Vetting*. Kjo pasuri është krijuar para lidhjes së martesës.

3. Apartament banimi me sipërfaqe 80 m², ndodhur në qytetin e Vlorës, vlera 52,000 euro

3.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “*Apartament banimi në pronësi të bashkëshortit tim (ku banojmë, në posedim), me sipërfaqe totale 80 m², të ndodhur në Vlorë, me vlerë 52,000 euro*”.

⁶ Vërtetim hipotekor nr. ***, datë 27.2.2004, për pasuri nr. *** në z. k. ***, Durrës, me sip. 200 m², shtëpi banimi e përbërë nga një dhomë, kuzhinë, sallon dhe ballkon me tulla e tjegulla, mbi një truall me sip. 200 m², në emër të shtetasve E.L dhe T.L.

3.2 Në deklaratën *Vetting* të personit të lidhur, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “*Apartament banimi në pronësinë time (ku banojmë), me sipërfaqe totale 80 m², ndodhur në Vlorë, në vlerën 52,000 euro*”. Personi i lidhur ka deklaruar edhe në DPV-në për vitin 2008 si burim krijimi për shtëpinë në Vlorë të ardhurat e fituara nga emigracioni dhe nga aktiviteti privat e publik. Kjo pasuri është krijuar para lidhjes së martesës.

Në seksionin e të ardhurave të deklaratës *Vetting*, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, ka deklaruar:

- Të ardhura nga emigracioni në Itali, që i referohet punësimit të ligjshëm në periudhën 1998 – 2004. Bashkëlidhur pjesë të dokumentacionit përkatës, konkretisht: fletë përmbledhjeje mujore e pagesave të përfituara si rrjedhojë e punësimit në fabrikën “****”, për periudhën 2000 – 2004; fletë përmbledhjeje mujore të përfituara si rrjedhojë e punësimit në “****”, për periudhën 1998 – 2000; shpërblim dëmi si pasojë e aksidentit në punë, në shumën 14,037 euro.
- Të ardhura nga emigracioni në Itali, që i referohet punës jo i siguruar në periudhën 1996 – 2004. Subjekti ka deklaruar: “*Lidhur me shumën e të ardhurave të fituara në emigracion nuk mund të përcaktoj saktësisht një shifër, kanë qenë më shumë se 150,000 euro*”.

3.3 Në DIPP-në e vitit 2008, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, i cili deklaron për herë të parë, ka deklaruar:

- Një apartament me sipërfaqe 80 m² në lagjen “****”, Vlorë (kontratë premtim shitjeje datë 9.4.2008, nr. *** rep., nr. *** kol.), me vlerë 52,000 euro.
- Një shtëpi private të përbërë nga dy dhoma, një kuzhinë, me sipërfaqe trualli 200 m², ndodhur në Durrës, në bashkëpronësi.
- Depozitë bankare pranë NBG Bank, Vlorë, në shumën 10,000 euro.
- Kursime 30,000 euro.

3.4 Si burim krijimi të të ardhurave, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: (i) të ardhura nga emigracioni 1996 – 2004; (ii) të ardhura nga aktiviteti privat 2004 – 2006; (iii) të ardhura nga aktiviteti publik 2006 – 2008.

3.5 Gjatë hetimit, subjekti ka sqaruar se nga fundi i muajit korrik 2008 ka nisur bashkëjetesën ligjore me bashkëshortin. Martesa ligjore është lidhur në datën 26.9.2008. Nga shtatori i vitit 2006 deri në tetor 2007, ka jetuar me qira me shoqen e saj, M.N. Nga muaji nëntor i vitit 2007 deri në korrik të vitit 2008, subjekti dhe shoqja e saj (po subjekt rivlerësimi) kanë banuar së bashku në apartamentin që kishte blerë më parë bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Ka rezultuar se apartamenti i banimit ku ka jetuar bashkë me shoqen, është blerë nga bashkëshorti përpara kohës së lidhjes së kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.4.2008, vërtetuar me faktin se në muajin nëntor të vitit 2007 subjekti i rivlerësimit ka zhvilluar ceremoninë e fejesës në këtë banesë. Gjithashtu, edhe nga shpjegimet e shoqes së subjektit të rivlerësimit, M.N, konfirmohet se kanë qëndruar së bashku në këtë banesë nga muaji nëntor 2007 deri në muajin korrik 2008.

3.6 Subjektit i është kërkuar të depozitohet pranë Komisionit praktikën e regjistrimit të kësaj pasurie, përfshirë kontratën e premtim shitjes, kontratën e shitjes, certifikatën e regjistrimit, kartelën dhe akte te tjera.

3.7 Subjekti ka depozituar me pyetësorin nr. 3 dokumentacionin e kërkuar, si vijon: (i) Kontratë premtim shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.4.2008, sipas së cilës pala shitëse e ardhshme S.B i shet palës blerëse të ardhshme E.L apartamentin me sipërfaqe 80 m², kundrejt çmimit 52,000 euro. Z. S.B, në bazë të kontratës paraprake të blerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.3.2007, deklaron se ka blerë një apartament me sipërfaqe 80 m², të ndodhur në lagjen “****”, rruga nr. ***, Vlorë, i cili është në fazën e regjistrimit në ZRPP nga ana e shoqërisë ndërtuese

“****” sh.p.k., e cila do të jetë edhe firma që do të bëjë kalimin e pasurisë së apartamentit në emrin e blerësit të fundit E.L.

ii) Kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.10.2023, e lidhur midis shtetasve S.B e S.B dhe blerësit E.L. Sipas kësaj kontrate, pala shitëse ka rënë dakord që të shesë pasurinë me nr. ***, vol. ***, fq. ***, të llojit apartament, me sipërfaqe 67,5 m², Vlorë, kundrejt çmimit prej 52,000 euro, nga të cilat vlera e apartamentit 42,000 euro dhe 10,000 euro vlera e mobilimit. Vlera totale e shitblerjes për likuidimin – sipas kontratës premtim shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.4.2008.

3.8 Gjithashtu, subjekti ka depozituar edhe kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.10.2023, ku në cilësinë e shitësit është bashkëshorti i saj, shtetasi E.L dhe blerës shtetasi D.S. Rezulton se kjo pasuri është shitur kundrejt çmimit 75,000 euro. Rezulton gjithashtu se pagesa nga blerësi është bërë nëpërmjet llogarisë së noterës.

ii) Në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti privat për periudhën 2004 – 2006

3.9 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura nga ushtrimi i punës në aktivitetin privat si menaxher në ish-shoqërinë “****” sh.p.k., me qendër në Tiranë, me administrator shtetasin Y.H, me status çregjistruar, periudha gusht 2004 – gusht 2006, me pagë mujore 100,000 lekë. Shuma e të ardhurave neto të krijuara: 2,500,000 lekë.

3.10 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, në lidhje me burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave, ndër të tjera, subjekti ka shpjeguar se bashkëshorti ka deklaruar në deklaratën e pasurisë për vitin 2008 se nga muaji gusht i vitit 2004 deri në muajin gusht të vitit 2006 ka punuar menaxher pranë shoqërisë “****” sh.p.k., me administrator në atë kohë shtetasin Y.H. Bashkëshorti dhe shtetasi Y.H kanë lidhje familjare. Bashkëshorti ka kryer detyrën e menaxherit dhe, për të vërtetuar këtë fakt, ka vënë në dispozicion të hetimit kartëvizitat e shtetasit E.L, deklaratën noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.5.2024, të shtetasve Y.H dhe E.L, si dhe ekstraktin e subjektit “****” sh.p.k., printuar në datën 30.4.2024.

3.11 Sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.5.2024, shtetasi Y.H ka deklaruar se gjatë periudhës 2004 – 2006 ka qenë ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT *** dhe ka bashkëpunuar me kunatin, z. E.L, në pozicionin e menaxherit. Gjithashtu, ka deklaruar se nga puna e tij si menaxher z. E.L ka gjeneruar gjatë kësaj periudhe vlerën prej 2,500,000 lekësh dhe për shkak të marrëdhënieve familjare nuk e kanë formalizuar marrëdhënien e bashkëpunimit.

3.12 Shtetasi E.L ka deklaruar se gjatë periudhës kohore 2004 – 2006 ka bashkëpunuar me kunatin e tij, shtetasin Y.H, në pozicionin e menaxherit pranë shoqërisë “****” sh.p.k. dhe për shkak të marrëdhënieve familjare nuk kanë formalizuar marrëdhënien e bashkëpunimit. Nga kjo marrëdhënie ka gjeneruar të ardhura prej 2,500,000 lekësh.

3.13 Sa më sipër, mbështetur në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni ka vlerësuar se bashkëshorti i subjektit nuk ka arritur të dokumentojë dhe provojë të ardhurat e ligjshme në shumën prej 2,500,000 lekësh, të deklaruara si burim për pasuritë e krijuara përpara martesës.

*Për efekt të analizës financiare, Komisioni nuk i ka konsideruar këto të ardhura si burim i ligjshëm për blerjen e dy apartamenteve tek zona e ***, Tiranë.*

iii) Në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti publik 2006 – 2008

3.14 Në deklaratën *Vetting*, në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti publik për vitet 2006 – 2008, subjekti ka depozituar vërtetim page me nr. *** prot., datë 27.10.2016, nga ZVRPP-ja Vlorë, sipas të cilit vërtetohet se shtetasi E.L ka qenë punonjës pranë ZVRPP-së Vlorë për periudhën 22.8.2006 – 30.8.2007, me pagë neto mujore/vjetore si më poshtë: “... Në total, shuma e pagave

dhe shpërblimeve nga ZVRPP Vlorë për periudhën kohore 22.8.2006 – 30.8.2007 është 384,209 lekë”.

3.15 Shkresë nr. *** prot., datë 26.1.2017, e Bashkisë Vlorë, Njësia Administrative ***, sipas së cilës vërtetohet se z. E.L ka filluar marrëdhënien e punës në pozicionin e inspektorit/juristit në datën 4.2.2008 dhe është larguar në datën 31.12.2008. Bashkëlidhur vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare. Vlera totale e përfituar nga kjo marrëdhënie punësimiti është 309,057 lekë. Vlera e të ardhurave e përfituar deri në datën e lidhjes së martësës 26.9.2008 është në shumën 220,938 lekë.

3.16 Në përfundim, Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar mundësinë e bashkëshortit të subjektit për të kursyer me të ardhura të ligjshme shumat e deklaruara në deklaratën fillestare, konkretisht depozitën bankare 10,000 euro dhe kursimet *cash* 30,000 euro, të përdorura për pagesën e këstit të parë prej 40,000 euro për apartamentet në zonën e ***, Tiranë.

3.17 Komisioni përfshiu në këtë analizë financiare edhe krijimin e dy pasurive, blerë me para të mbledhura në kohë me burim të ardhurat nga emigracioni, deklaruar si burim edhe për apartamentet në Tiranë, paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 1

Përshkrimi	Total dhjetor 1998 – 26.9.2008
Pasuritë	13,103,860
Apt. banimi në pronësi të bashkëshortit, me sip. 80 m ² , në Vlorë, 9.4.2008	7,290,400
Një shtëpi private banimi (e amortizuar) dhe truall 200 m ² , Durrës – trashëguar	875,000
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve</i>	4,938,460
Likuiditete në banka	1,242,985
<i>Cash</i> deklaruar në DPV	3,695,475
Gjendja e likuiditeteve	
Detyrime	783,222
Kredia NBG Bank sipas kontratës datë 13.8.2008	800,000
<i>Pagesë kësti (principali + interesi)</i>	(16,778)
	-
Pasuri neto (pasuri - detyrime)	12,320,638
Të ardhurat	11,109,122
Të ardhurat nga puna në Itali	10,503,975
Të ardhurat nga puna në Shqipëri	605,147
Shpenzimet	5,618,583
Shpenzime jetike Itali	4,313,402
Shpenzime jetike Shqipëri	505,181
Shuma e kredisë e tërhequr/shpenzuar	800,000
Mundësia për kursime	-6,830,100

Analiza financiare për pagesën e shumës 40,000 euro në vitin 2009

3.18 Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar mundësinë e subjektit dhe bashkëshortit për të paguar në datën 22.12.2009 këstin e apartamentit prej 40,000 euro. Në tabelën e mëposhtme nuk janë përfshirë likuiditetet, konkretisht depozita bankare në vlerën 10,000 euro dhe kursimet *cash* në vlerën 30,000 euro.

Tabela nr. 2

Përshkrimi	2009
Pasuritë	5,647,916
Dy apt. banimi, të bashkuar në 1, në bashkëpronësi me bashkëshortin, me sip. 181.2 m ² , ***, Tiranë. Paguar 40,000 euro më 22.12.2009	5,518,400
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve</i>	<i>129,516</i>
Likuiditete në banka	7,305
Cash deklaruar në DPV	700,000
Gjendja e likuiditeteve	207,582
Detyrime	(771,803)
Kredia NBG Bank sipas kontratës datë 13.8.2008	
<i>Pagesë kësti (principali + interesi) nga data 26.9.2008</i>	<i>(771,803)</i>
Pasuri neto (pasuri - detyrime)	6,419,719
Të ardhurat	625,651
Të ardhurat nga paga subjekti	236,946
Të ardhurat nga leja e lindjes	304,432
Të ardhurat nga interesat bankarë	84,273
Shpenzimet	614,603
Shpenzime jetike	364,320
Shpenzime udhëtimi	250,283
Mundësia për kursime	-6,408,671

3.19 Në përfundim të hetimit, Komisioni i dërgoi subjektit barrën e provës, ku duket se:

- Subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare që me të ardhura të ligjshme të paguajnë në datën 22.12.2009 këstin 40,000 euro, pasi ka rezultuar me balancë negative në shumën 6,408,671 lekë, në analizën e kryer për vitin 2009.
- Subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare që me të ardhura të ligjshme të kursejnë vlerat e deklaruara në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2008, konkretisht depozitën bankare në vlerën 10,000 euro dhe kursimet *cash* në vlerën 30,000 euro, pasi kanë rezultuar me balancë negative në shumën 6,830,100 lekë në analizën e kryer për periudhën dhjetor 1998 – 26 shtator 2008.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me të ardhurat nga emigracioni

3.20 Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar pas dërgimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore, ndër të tjera, se:

- Bashkëshorti për kohën përpara lidhjes së martesës në datën 26.9.2008 nuk duhet të kualifikohet si person i lidhur ose person tjetër i lidhur.
- Bashkëshorti nuk ka pasur asnjë lidhje me subjektin të asaj natyre që parashikojnë pikat 13 dhe 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 përpara lidhjes së martesës, që shënon fillimin e bashkëjetesës ligjore ndërmjet saj dhe bashkëshortit.
- Ka jetuar nga muaji shtator 2006 deri në muajin korrik 2008 me subjektin e rivlerësimit M.N (O), emëruar si magjistrate, përkatësisht si prokurore dhe gjyqtare pranë Gjykatës dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
- Bashkëshorti kishte blerë me të ardhurat e tij apartamentin në qytetin e Vlorës përpara se të njihej me subjektin.

- Nuk ka bashkëjetuar me bashkëshortin deri në ditën e kurorëzimit të martesës.
- Prindërit e bashkëshortit, edhe pse kanë emigruar në Itali që prej vitit 1996, kanë vijuar të mbajnë në pronësinë e tyre apartamentin e përfutur që nga koha e privatizimit, sipas kontratës së lidhur me ish-Entin e Banesave, apartament të cilin bashkëshorti e ka përdorur si vendbanim të tij gjatë kohës që subjekti ka qëndruar me shoqen e saj në apartamentin e blerë prej tij.
- Dy pasuritë e paluajtshme (apartamenti me sipërfaqe 80 m², në lagjen “****”, Vlorë, shtëpi private e përbërë nga dy dhoma e një kuzhinë me sipërfaqe trualli 200 m², e amortizuar, e ndodhur në Durrës), si dhe shuma monetare prej 40,000 euro, kanë qenë në pronësi të plotë të bashkëshortit.
- Burimi i krijimit të dy pasurive të paluajtshme përpara martesë, si dhe shumës 40,000 euro, është deklaruar rregullisht nga bashkëshorti në deklaratën për vitin 2008, në kontrollin e pasurisë së kryer në vitin 2012 nga ILDKPKI-ja, në deklaratën *Vetting* dhe nuk ka ardhur në këtë proces si një deklaram i posaçëm vetëm për efekt të justifikimit të burimeve të pamjaftueshme të të ardhurave.
- Në periudhën para martesës, subjekti dhe bashkëshorti kanë vepruar financiarisht në autonomi të plotë.
- Në asnjë rast si burim për krijimin e pasurive të sipërcituara nuk kanë shërbyer të ardhurat e subjektit, pasi në kohën kur janë përfutur nga bashkëshorti të ardhurat për të krijuar këto pasuri, subjekti nuk njihej me të.
- Në asnjë rast subjekti nuk ka kryer veprime dhe nuk ka bërë transaksione bankare ose jo bankare, që kanë lidhje qoftë me blerjen e pasurive në pronësi të bashkëshortit, qoftë likuidimin e çmimit të blerjes së tyre apo dhe me akumulimin e të ardhurave në formën e kursimeve *cash*.
- Komisioni gjatë hetimit administrativ nuk e ka pyetur subjektin në lidhje me shpenzimet jetike të bashkëshortit përpara martesës dhe nga kush janë përballuar këto shpenzime. Gjithashtu, Komisioni nuk ka kryer analizën financiare sipas përbërjes së certifikatës familjare të bashkëshortit për periudhën përpara martesës, objekt analize.
- Bashkëshorti ka jetuar në Itali me familjen e tij, prindërit dhe vëllanë. Ky fakt vërtetohet nga dokumentet e të ardhurave për secilin pjesëtar të familjes, që identifikon të njëjtën adresë banimi “****”, si dhe nga certifikata historike familjare, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Bashkia ***, datë 23.10.2024 dhe certifikata historike e vendbanimit, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Sektori i Shërbimeve Demografike, Bashkia ***, datë 22.10.2024. Këto dokumente tregojnë se secili anëtar ka jetuar në të njëjtën adresë dhe bashkëshorti ka pasur një ekonomi të përbashkët me prindërit. Të ardhurat që ka krijuar bashkëshorti para martesës në emigracion, në shumën 80,803 euro dhe që kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurive të fituara po para martesës, të deklaruara në DPV-në e vitit 2008, janë kursyer të gjitha. Të ardhurat e familjes së tij, bashkë me të ardhurat e bashkëshortit, të realizuara për periudhën kohore 1996 – 2008, janë në shumën 326,000 euro.
- Analiza financiare e kryer vetëm për bashkëshortin, në kushtet kur ai ka jetuar me prindërit dhe vëllanë, është tërësisht e gabuar dhe nuk paraqet një fotografim të situatës ekonomiko-financiare të familjes së bashkëshortit.
- Sikurse rezulton nga analiza financiare, deri në fund të vitit 2004 mundësia për kursim e familjes së bashkëshortit është në shumën 74,632 euro, ndërsa deri në fund të vitit 2008 është në shumën 91,736 euro, pra gjithsej në shumën 166,368 euro.
- Sikurse rezulton, bashkëshorti në fund të vitit 2008 ka pasur mundësi të marrë nga familja të ardhurat e ligjshme të tij nga emigracioni në shumën 80,308 euro. Shpenzimet e jetesës

janë përballuar nga familja. Prindërit e bashkëshortit nuk kanë shtuar pasuri, ata kanë kontribuar në jetesën e përbashkët dhe në sigurimin e të ardhurave si për bashkëshortin, ashtu dhe vëllanë e tij. Ky fakt vërtetohet edhe me deklaratën përpara noterit, datë 27.10.2024, të nënës së bashkëshortit, shtetases H.L, që ka deklaruar se: *“...si prindër nuk jemi mbështetur në punën e tyre, përkundrazi, qëllimi ynë ka qenë që çdo e ardhur që ata kanë fituar me mund e djersë, të kishin mundësi ta investonin për t’i krijuar vetes një të ardhme ndryshe nga ajo çfarë ne, prindërit e tyre, kishim jetuar në Shqipëri...”*

iv) Në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti privat në vitet 2004 – 2006

3.21 Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar pas dërgimit të barrës së provës dhe në seancë dëgjimore, ndër të tjera, se:

- Bashkëshorti ka qenë i punësuar pranë shoqërisë “****” sh.p.k., me qendër në Tiranë, në cilësinë e menaxherit. Në deklaratën e vitit 2008 ka deklaruar të ardhura nga puna në aktivitet privat për vitet 2004 – 2006. Ky fakt është verifikuar nga ILDKPKI-ja në vitin 2012, kur është kryer kontrolli i pasurisë së subjektit, të përzgjedhur me anë të shortit.
- Për shkak të marrëdhënies familjare, si dhe faktit që nuk e dinte nëse do t’i pëlqente puna ose jo, nuk formalizuan marrëdhënien e punës. Gjatë kësaj periudhe, bashkëshorti ka qenë në Shqipëri dhe nuk figuron në marrëdhënie pune në ndonjë qendër pune.
- Fakti që punësimi i bashkëshortit nuk ka qenë deklaruar nga punëdhënësi pranë organit kompetent, lidhej me informalitetin e kohës, informalitet që është i pranishëm edhe në ditët e sotme.
- Pagesa e detyrimeve tatimore për pagën e marrë nga bashkëshorti ka qenë detyrim i punëdhënësit për deklarimin dhe kryerjen e pagesave mujore të detyrimeve tatimore.
- Marrëdhënia e punës ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe bashkëshortit provohet nga: kartëvizitat e bashkëshortit në cilësinë e menaxherit; kartëvizitat e furnitorëve që kanë pasur të njëjtin objekt aktiviteti me shoqërinë “****” sh.p.k.; numrin e telefonit të bashkëshortit dhe adresa e tij *email* në *domain*-in e shoqërisë; deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.5.2024; udhëtimet që bashkëshorti ka pasur me shtetasin Y.H në datat 19.9.2004, 30.3.2005, 3.5.2005, 29.5.2005, 20.2.2006 dhe 30.3.2006, konfirmuar nga të dhënat e sistemit TIMS; transaksionet e kryera në tri llogaritë bankare pranë ProCredit Bank sh.a.; derdhja e shumave monetare në llogarinë bankare me numër *** dhe pagesa e tre muajve të Vodafone-it, prill 2005, maj 2005 dhe korrik 2005; derdhjet e shumave monetare në llogarinë bankare me numër *** dhe pagesat e kryera ndaj të tretëve në periudhën nëntor 2004 – qershor 2006; derdhja e shumës monetare në llogarinë me numër *** dhe pagesa e kryer në datën 30.6.2006. Të gjitha këto dokumente, transaksione dhe udhëtime të kryera tregojnë marrëdhënien e punës së bashkëshortit me shoqërinë “****” sh.p.k.
- Në lidhje me të ardhurat e mësipërme, në përputhje me kuadrin ligjor të zbatueshëm, pagesa për të gjitha tatimet dhe kontributet është përgjegjësi e punëdhënësit dhe, sa më sipër, ka qenë përgjegjësia e punëdhënësit të bashkëshortit për të kryer çdo pagesë dhe për t’i dokumentuar ato (vendimi nr. 13, datë 20.6.2019, i Kolegjit). Të ardhurat janë të ligjshme, pasi janë deklaruar si në deklaratën vjetore *Vetting*, ashtu dhe në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së. Këto të ardhura janë përfituar nga bashkëshorti para njohjes me subjektin e rivlerësimit. Në këtë kuptim, vlerësimi dhe analizimi i tyre nuk duhet të shtrihet në të njëjtën masë nëse këto të ardhura do të gjeneroheshin gjatë periudhës së martesës me subjektin deklarues.
- Nga të ardhurat nga punësimi në shoqërinë “****” sh.p.k., bashkëshorti, sipas analizës financiare, ka pasur mundësi të kursejë shumën prej 2,100,000 lekësh.

- Shuma prej 2,100,000 lekë është paguar për blerjen e apartamentit në Vlorë dhe pjesa tjetër e çmimit të blerjes së këtij apartamenti është shlyer nga një pjesë e kursimeve të shumës 80,308 euro, që bashkëshorti ka kursyer nga puna e ligjshme në emigracion.
- Kursimi monetar i deklaruar rregullisht nga bashkëshorti që në DPV-në për vitin 2008, në shumën 40,000 euro, që ka shërbyer si burim për pagesën e këstit të parë të dy apartamenteve të bashkuara në një të vetëm në Tiranë, sipas dokumentacionit dhe analizës financiare të kryer, rezulton se është pjesa e mbetur e kursimeve prej 80,308 euro.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

3.22 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se rezulton e provuar se:

- Personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, gëzon statusin e personit të lidhur nga data 26.9.2008, datë në të cilën ata kanë filluar bashkëjetesën pas lidhjes së martesës ligjore. Rezulton e provuar se subjekti dhe bashkëshorti kanë nisur bashkëjetesën pikërisht në këtë kohë, sepse subjekti përpara martesës ka jetuar në qytetin e Vlorës për shkak të detyrës, për disa vite rresht me një subjekt tjetër rivlerësimi, znj. M. N. Vitin e fundit, ato kanë jetuar në apartamentin në pronësi të personit të lidhur, pasuri kjo e krijuar para martesës dhe, për më tepër, para fejesës së subjektit me bashkëshortin e saj.

Njohja midis tyre nuk përbën ndonjë status ligjor, si rrjedhojë nuk krijon asnjë detyrim ligjor për subjektin për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të krijuara prej bashkëshortit për periudhën para martesë, para datës 26.9.2008.

- Objekt i procesit të rivlerësimit janë pikërisht pasuritë dhe likuiditetet e personit të lidhur të krijuara gjatë martesës, me kontributin e përbashkët të tyre, duke shmangur penalizimin e subjektit për pasuri apo likuiditete të krijuara nga bashkëshorti para martesë dhe pa dyshim kur këto nuk vijnë nga veprimtari të paligjshme. Për këtë arsye, analiza do të vijojë me të ardhurat e deklaruara nga personi i lidhur në DIPP-në e vitit 2008, në vlerën 40,000 euro, të cilat kanë shërbyer për pagesën e këstit të parë të pasurisë së paluajtshme apartament të ndodhur në Tiranë, objekt analize.
- Në analizën financiare të kryer nga ana e Komisionit, metodologjia e ndjekur ka të bëjë me llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të personit të lidhur dhe familjarëve të tij nga puna në emigracion për periudhën 1998 – 2004, të ardhura në formën e kursimeve, të cilat kalojnë testin e parashikuar në nenin D, pika 3 e Kushtetutës, dhe që janë në vlerën 74,632 euro. Diferenca e konstatuar në rezultatet e hetimit ka ardhur si pasojë e zbritjes së vlerës së dy pasurive të paluajtshme të krijuara para martesë me subjektin e rivlerësimit dhe të analizës vetëm të të ardhurave të personit të lidhur për periudhën 2004 – 2008, të cilat janë analizuar gjithashtu mbi kërkesat e parashikuara nga neni D, pika 3 e Kushtetutës. Duke aplikuar këto kërkesa, Komisioni konstaton se personi i lidhur duket se ka pasur mundësi të ketë poseduar vlerat 40 mijë euro, 30 mijë euro gjendje *cash* dhe 10 mijë euro në llogari bankare, e deklaruar në DIPP-në e vitit 2008, me burime të ligjshme vetëm vlerën 11 mijë euro.
- Sa më sipër, trupi gjykues çmon se në kushtet kur këto të ardhura janë deklaruar të gjeneruara para lidhjes së martesës me subjektin e rivlerësimit dhe duke qenë se nga hetimi nuk rezultoi që ato të jenë gjeneruar nga kryerja e veprimeve të paligjshme apo të jenë ngritur dyshime se janë të ardhura për të cilat mund të ketë kontribuuar subjekti i rivlerësimit, të ardhurat e deklaruara nga personi i lidhur në DIPP-në e vitit 2008 duhet të përfshihen në analizën financiare lidhur me pagesën e kryer në shumën 40,000 euro për pasurinë apartament në Tiranë. Trupi gjykues çmon gjithashtu se kjo vlerë, edhe sikur të konsiderohet si e krijuar me burime të paligjshme, nuk mund të ndikojë në bilancin negativ të subjektit të rivlerësimit gjatë bashkëjetesës së tyre. Përmendim këtu dhe argumentin se

personi i lidhur ka deklaruar të ardhura nga emigracioni në një vlerë të konsiderueshme dhe që provohen se kanë qenë të tilla. Në këtë logjikë, nuk përjashtohet mundësia që familja e personit të lidhur investimet e kryera t'i ketë financuar me të ardhura jo nga burime të ligjshme, sipas nenit D, pika 3 e Kushtetutës, jo e detyrueshme kjo gjë për persona që nuk kanë pasur detyrim ligjor për të deklaruar. Gjithashtu, nga bashkëshorti i subjektit në deklaratën *Vetting* janë deklaruar të ardhura nga emigracioni nga punësimi jo i siguruar në harkun kohor 1996 – 2004, në një vlerë rreth 150,000 euro.

- Në lidhje me të ardhurat nga ushtrimi i punës në aktivitetin privat të personit të lidhur si menaxher në ish-shoqërinë “****” sh.p.k., me qendër në Tiranë, në harkun kohor gusht 2004 – gusht 2006, me pagë mujore 100,000 lekë, si gjatë hetimit, edhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit subjekti i rivlerësimit nga tërësia e dokumentacionit të dorëzuar arriti të provojë ekzistencën e një marrëdhënieje punësimi, pasi ekzistojnë indicie të mjaftueshme që lidhen me njëra-tjetrën, por nuk u provua me dokumentacion ligjor masa e shpërblimit të marrë, si dhe pagimi i detyrimeve tatimore, për pasojë të ardhurat e krijuara mbetën në nivel deklarativ.
- Për sa i përket të ardhurave të personit të lidhur gjatë ushtrimit të veprimtarisë si avokat për vitin 2009, trupi gjykues mori në konsideratë parashtrimet e subjektit, si dhe Kolegjit lidhur me llogaritjen e të ardhurave dhe çmon se vlera e fitimit pas marzhit të fitimit prej 80%⁷ fitimi neto do të rezultonte në vlerën 1,680,000 lekë.
- Në lidhje me shpenzimet e udhëtimit, të cilat janë përlllogaritur në vlerën 250,283 lekë, trupi gjykues çmon se subjekti nuk depozitoi prova, akte juridike të tilla, si marrëveshje me klientët apo akte përfaqësimi, të cilat të provonin mbulimin e këtyre shpenzimeve. Trupi gjykues çmon se ato mbeten në të njëjtën vlerë të llogaritur në rezultatet e hetimit.
- Sa më sipër, trupi gjykues çmon se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mundësi financiare të paguajnë në datën 22.12.2009 këstin prej 40,000 euro.

Në lidhje me kredinë e marrë në NBG Bank në vlerën 30,000 euro

3.23 Subjekti me deklaratën *Vetting* ka depozituar kontratë kredie bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.1.2010, nga NBG Bank, në shumën 30,000 euro, me qëllim blerjen e një apartamenti në ***, Tiranë, Komuna ***. Kredimarrës E.L dhe Eranda Laze dhe dorëzanës P.L, H.L, Xh.L dhe L.L. Me kontratën e kredisë si më sipër banka u ka dhënë huamarrësve E.L dhe Eranda Laze një hua në shumën 30,000 euro, me qëllim për t'u përdorur për blerjen e apartamentit si më sipër.

3.24 Si kolateral për kredinë e dhënë është vendosur një apartament me nr. ***, vol. ***, fq. ***, z. k. ***, me sip. 89.9 m², me adresë lagjja “****”, rr. “****”, prona është e regjistruar në ZVRPP-në Vlorë në pronësi të shtetasve P.Xh.L, Y.Y.L, Xh.P.L, L.P.L, që vërtetohet nga certifikata e pronësisë me datë 16.12.2009.

3.25 Në bazë të të dhënave nga NBG Bank⁸, rezulton se në datën 19.1.2010 është kryer kalimi i shumës prej 29,100 euro sipas kushteve të kontratës së kredisë të marrë pranë NBG Albania sh.a. - transferimi i shumës nga llogaria e mbajtur në emrin E.P.L, në llogarinë “****” sh.p.k., me përshkrimin “Këst apartamenti sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol. dhe kontratës së kredisë nr. ***.

⁷ Në jurisprudencën e Kolegjit, marzhi i fitimit për aktivitetin e avokatit është vlerësuar 80%. Referuar vendimit nr. 20/2023, paragrafi 12.17; vendimit nr. 33/2021, paragrafi 30.

⁸ Shihni përgjigjen e ZQRPP-së në dosjen e ILDKPKI-së me nr. *** prot., datë 5.10.2017.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

3.26 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se nuk rezultuan problematika lidhur me këtë deklaram, duke qenë se ka përputhje me deklaramin e bërë, si dhe me dokumentacionin bankar të administruar gjatë procesit të rivlerësimit.

Në lidhje me pagesën e këstit të fundit në vlerën 11,284 euro

3.27 Nga hetimi rezulton se në DIPP-në e vitit 2010, në rubrikën e detyrimeve, subjekti ka deklaruar se ka paguar për dy apartamente banimi shumën 40,000 euro + 30,000 euro. Ndërkohë, në DIPP-në e viteve 2010 – 2014, subjekti nuk ka deklaruar detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., por vetëm kredinë e marrë në NBG Bank.

3.28 Nga dokumentacioni i administruar nga ana e ILDKPKI-së, pranë ASHK-së, Tirana Rurale 1, bashkëlidhur praktikës së regjistrimit gjenden dy mandatarkëtime, mandatarkëtimi nr. ***, datë 22.12.2009, për pagesën e shumës prej 40,000 euro, me përshkrimin “Kësti i shtëpisë, arkëtuar nga E.L në favor të shoqërisë “****” sh.p.k.”, si dhe mandatarkëtimi datë 10.1.2014, arkëtuar nga E.L në vlerën 11,284 euro, me përshkrimin “Për blerje apartamenti objekti Tiranë, në favor të shoqërisë “****” sh.p.k.”

3.29 Gjatë procesit të rivlerësimit, në pyetësorin standard subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shuma 10,000 euro është shlyer në fund të vitit 2010, kohë kur është dorëzuar apartamenti. Shuma e mbetur rreth 1,200 euro është paguar në fund të vitit 2013. Për shumat e fundit të paguara është bërë vetëm një mandatarkëtim përmbledhës, nënshkruar nga bashkëshorti dhe shoqëria “****” sh.p.k. Shpenzim tjetër ka qenë për blerjen e automjetit tip “****”, me targa VL *** D, në bazë të kontratës së shitblerjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.6.2010, në shumën 980,000 lekë. Si burim financiar për kryerjen e këtij shpenzimi kanë shërbyer kursimet e saj nga paga e vitit 2008, të deklaruara në shumën prej 500,000 lekësh dhe shuma e mbetur ka qenë pjesë e kursimeve të përbashkëta të viteve 2009 – 2010”.

3.30 Sa më sipër, lidhur me momentin e deklaramit të kryerjes së pagesës së vlerës 10 mijë euro, Komisioni në përfundim të rezultateve të hetimit konkludoi se pagesa e vlerës prej 11,284 euro është kryer pikërisht në datën e mandatit të arkëtimit, pra në vitin 2014, duke e përfshirë pikërisht në analizën financiare të këtij viti, si dhe duke pasur parasysh se:

- Të ardhurat e deklaruara nga bashkëshorti i subjektit në vitin 2009 nuk do të përfshihen në analizën financiare, pasi janë të ardhura të cilat nuk përmbushin kriteret e përcaktuara nga pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- Komisioni ka verifikuar deklaramat periodike të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit lidhur me kursimet *cash*, nga ku rezulton se në DIPP-në e vitit 2009 subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar “Kursime nga paga vjetore e vitit 2008 (duket lapsus, pasi viti i deklaramit është 2009). Shuma 200,000 lekë”. Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti dhe bashkëshorti nuk deklarojnë kursime *cash*, as pakësim të kursimeve, por deklarojnë se kanë blerë një automjet në datën 30.6.2010, në vlerën 980,000 lekë, me burim kursimet e tyre. Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti dhe bashkëshorti kanë deklaruar: “Kursime nga të ardhurat vjetore. Shuma: 100,000 lekë”. Në DIPP-në e viteve 2012 dhe 2013, subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar kursime. Nga sa më sipër, duket se kursimet *cash* të deklaruara për vitin 2009 në shumën 200,000 lekë janë përdorur në vitin 2010 për blerjen e automjetit dhe, për rrjedhojë, ato nuk mund të kenë shërbyer si burim për pagesën e shumës 11,284 euro në vitin 2014, ndërsa në vitin 2010 nuk rezultojnë kursime *cash* të deklaruara, të cilat të mund të jenë përdorur në vitin 2014.

3.31 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e administruar dhe deklaramet e subjektit të rivlerësimit, përpiloi një analizë paraprake për periudhën 1.1.2014 – 10.1.2014, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur (bashkëshortit) për pagimin

e shumës 11,284 euro në datën 10.1.2014, si çmim i blerjes së apartamenteve në zonën e ***, Tiranë, kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara, konkretisht:

Tabela nr. 3

Përshkrimi	1.1.2014 – 10.1.2014
Pasuritë	1,547,820
Dy apt. banimi, të bashkuar në 1, në bashkëpronësi me bashkëshortin, paguar kësti 11,284 euro	1,581,340
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve</i>	<i>(33,520)</i>
Likuiditete në banka	255,518
Cash deklaruar në DPV	100,000
Gjendja e likuiditeteve	355,518
Detyrime	-
Pasuri neto (pasuri - detyrime)	1,547,820
Të ardhurat	33,386
Të ardhurat nga paga subjekti	0
Të ardhurat nga leja e lindjes	0
Të ardhurat nga aktiviteti si avokat	33,386
Shpenzimet	30,555
Shpenzime jetike	30,555
Mundësia për kursime	-1,544,990

3.32 Nga analiza financiare e mësipërme duket se subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur mundësi të kryejnë me të ardhura të ligjshme pagesën për apartamentet në shumën 11,284 euro, në datën 10.1.2014, pasi kanë rezultuar me balancë negative në shumën -1,544,990 lekë.

3.33 Nga hetimi rezultoi se sipas informacionit të ABI Bank⁹ subjekti rezulton bashkëmbajtëse e llogarisë nr. *** (ish nr. ***), së bashku me personin e lidhur E.L. Nga *statement*-i i bankës për periudhën 3.3.2010 – 7.6.2010¹⁰ ka rezultuar se llogaria është kredituar në total në shumën 23,749 euro dhe debituar në total në shumën 21,250 euro.

3.34 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të provojë burimin e ligjshëm të: (i) pagesës së këstit prej 11,284 euro në datën 10.1.2014; (ii) shumave të kredituara dhe të japë shpjegime në lidhje me destinacionin e përdorimit të tyre.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me kohën e pagesës së vlerës 10,000 euro

3.35 Subjekti pas kalimit të barrës së provës deklaroi, ndër të tjera, se: “Mandati i dytë në vlerën 11,284 euro është bërë midis palëve për nënshkrimin e kontratës përfundimtare të shitblerjes, pasi mungonte dokumentimi me mandat i pagesës 10,000 euro në fund të vitit 2010, si dhe pagesës 1,284 euro në fund të vitit 2013. Mandati i datës 10.1.2014 lidhet vetëm me dokumentimin e pagesës së mbetur, por jo me faktin se shuma 11,284 euro është likuiduar nga ana jonë në vitin 2014. Pagesa e shumës 11,284 euro lidhet me momentin e dorëzimit të pasurive të paluajtshme, marrë në dorëzim në vitin 2010 dhe jo në momentin e lëshimit të certifikatave të pronësisë”.

⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 6.9.2024, e ABI Bank.

¹⁰ Datë 3.3.2010, kredituar në llogari me transfertë shuma 7,024 euro, urdhëruar nga shtetasi T.P.L, vëllai i bashkëshortit të subjektit; datë 3.3.2010, depozituar *cash* shuma 5,225 euro; datë 3.3.2010, tërhequr *cash* shuma 5,225 euro; datë 4.3.2010, tërhequr *cash* shuma 6,525 euro; datë 12.3.2010, depozituar *cash* shuma 5,000 euro; datë 16.3.2010, tërhequr *cash* shuma 3,500 euro; datë 19.3.2010, depozituar *cash* shuma 1,500 euro; datë 1.4.2010, tërhequr *cash* shuma 1,000 euro; datë 7.6.2010, depozituar *cash* shuma 5,000 euro; datë 7.6.2010, tërhequr *cash* shuma 5,000 euro.

3.36 Subjekti shpjegon se DPV-ja e vitit 2010 është dorëzuar në datën 30.3.2011, pak më shumë se një muaj nga lindja e djalit dhe, për këtë arsye, DPV-ja e vitit 2010 ka pasaktësi në lidhje me pagesën e shumës 10,000 euro dhe deklarimit të detyrimit të mbetur 1,284 euro. Në pyetësoin standard, subjekti ka deklaruar se shuma 10,000 euro është shlyer në fund të vitit 2010, kohë kur është dorëzuar apartamenti. Shuma e mbetur rreth 1,200 euro është paguar në fund të vitit 2013. Gjithashtu, subjekti shpjegon se nuk ka arsye ekonomike pse shoqëria “****” sh.p.k. do të priste 3 vite për arkëtimin e shumës 11,284 euro, që është rreth 14% e çmimit të shitjes, ose më shumë se fitimi neto që ka realizuar nga shitja e pasurive të paluajtshme (duke mbajtur në konsideratë se fitimi minimal në ndërtim është 10%). Subjekti parashtron, ndër të tjera, se në analizën financiare të vitit 2010 janë përfshirë si shpenzime lëvizjet bankare në shumën 2,948,863 lekë. Këto lëvizje bankare nuk janë kryer nga bashkëshorti i saj, fakt që provohet me akt-ekspertimin grafik të nënshkrimit.

Lidhur me transaksionet e kryera në llogarinë bankare në ABI Bank

3.37 Subjekti ka shpjeguar se ajo vetë nuk ka hapur asnjë llogari bankare pranë ish-NBG Bank, Dega Vlorë. Është edhe një kërkesë e nënshkruar nga bashkëshorti, por jo e plotësuar prej tij, nëpërmjet së cilës autorizohet subjekti si bashkëmbajtëse e kësaj llogarie, edhe pse ajo nuk ka dhënë pëlqimin. Nga përmbajtja e dokumentacionit bankar është konstatuar se në datën 3.3.2010, në orën 13:58, është depozituar *cash* shuma 5,225 euro dhe, po në këtë datë, në orën 15:15 është tërhequr fillimisht shuma prej 5,000 euro dhe në orën 15:48 minuta është tërhequr përsëri shuma 500 euro. Në mandatet që tregojnë se këto shuma janë tërhequr nga bashkëshorti, konstatohet dukshëm se nuk është nënshkrimi i bashkëshortit. Në datën 4.3.2010, në orën 15:17 është kryer tërheqje në shumën prej 6,525 euro dhe në mandatin përkatës konstatohet qartësisht se nuk është firma e bashkëshortit. Në datën 12.3.2010, në orën 12.47, është depozituar shuma 5,000 euro dhe në datën 16.3.2024 rezulton të jetë tërhequr shuma 3,500 euro nga bashkëshorti, kur ky i fundit dhe subjekti ndodheshin jashtë shtetit. Në mandatin përkatës rezulton qartë se nuk është nënshkrimi i tij. Përveçse është e dukshme, në funksion të provueshmërisë së këtij fakti është kryer ekspertim grafik nënshkrimi nr. ****, datë 27.10.2024, që ka konkluduar për secilin prej mandateve të depozitimit dhe tërheqjeve se nuk janë të nënshkruara nga ana e personit të lidhur. Nga përmbajtja e mandateve të depozitimit të shumave monetare rezulton se asnjë depozitim nuk është kryer nga bashkëshorti i subjektit, por depozitimet e shumave përkatëse janë kryer nga shtetasit T.L dhe T.N, të cilët kanë qenë punonjës në këtë bankë, vërtetuar kjo me vërtetimet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Kjo tregon se llogaria bankare është përdorur nga të tretë në padijeni të tyre. Këtë e vërteton jo vetëm fakti që mandatet e tërheqjes së shumave monetare nuk janë nënshkruar nga bashkëshorti i saj, por edhe natyra e kryerjes së veprimeve bankare, depozitime dhe tërheqje në *cash* të shumave monetare respektive, në po të njëjtën ditë, në po të njëjtin hark kohor, tregon se mund të jetë përdorur kjo llogari për efekt të kryerjes së këmbimit valutor. Në vijim, subjekti shpjegon se pavarësisht faktit se këto transaksione nuk janë kryer nga bashkëshorti, edhe nëse nga Komisioni do të konsideroheshin si veprime të kryera prej tyre, ata kanë pasur mundësi financiare të depozitojnë me të ardhura të ligjshme shumën 5,225 euro në datën 3.3.2010, pasi kishin gjendje *cash* nga fundi i vitit 2009 në shumën 700,000 lekë. E njëjta situatë paraqitet edhe në depozitimin e datës 12.3.2010, 7.6.2010, respektivisht në shumën 5,000 euro. Subjekti parashtron se është e provuar që këto transaksione nuk janë kryer nga bashkëshorti, por edhe nëse do të ishin kryer prej tij, këto transaksione nuk mund të kenë efekt financiar në analizë, pasi lëvizjet në llogari bankare është absurde dhe në kundërshtim me çfarëdolloj metodologjie të trupave të rivlerësimit të konsiderohen shpenzime të vitit.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

3.38 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, për pagesën e vlerës 10 mijë euro dhe transaksionet bankare në ABI Bank, çmon se:

- Lidhur me kohën se kur subjekti dhe personi i lidhur kanë kryer pagesën e vlerës 10 mijë euro, trupi gjykues krijoi bindjen se është fundi i vitit 2010 pikërisht data e dorëzimit të apartamentit nga firma e ndërtimit. Kjo për arsye se subjekti i rivlerësimit e parashtron këtë fakt jo gjatë hetimit administrativ apo pas dërgimit të rezultateve të hetimit, por e ka bërë këtë deklaram në pyetësorin standard, si hapi i parë hetimor i procesit dhe me rëndësi relevante për procesin, duke parashtruar dhe pasaktësitë në deklaramet periodike 2010 – 2014. Ky detyrim për subjektin dhe bashkëshortin e saj ka lindur si një detyrim i përcaktuar në kontratën e prenotimit të apartamentit dhe që është dorëzimi i apartamentit nga firma e ndërtimit. Përpilimi i mandatarkëtimit në muajin janar të vitit 2014 lidhet me përgatitjet e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin e pasurisë.
- Në analizën financiare të vitit 2010, e cila do të parashtrohet në tabelën përfundimtare në këtë vendim, është e rëndësishme të analizohen pikërisht lëvizjet në llogarinë bankare pranë ABI Bank në emër të subjektit dhe personit të lidhur.
- Komisioni çmon se kjo llogari, pavarësisht se është dyemërore, nuk rezulton në asnjë prej dokumenteve të dërguara nga banka që subjekti të ketë dhënë dakordësinë në një llogari dyemërore. Gjithashtu, rezulton e provuar se subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë asnjë kontribut në derdhjet dhe tërheqjet e kryera gjatë vitit 2010 në këtë llogari. Derdhjet dhe tërheqjet në këtë llogari janë kryer nga vëllai i personit të lidhur, z. T.L dhe shtetasi T.N, dhe kjo përforcohet nga fakti që derdhjet dhe tërheqjet e bëra në datat 16 dhe 19 mars 2010 nuk janë kryer as nga personi i lidhur dhe as nga vëllai i tij, pasi ky i fundit, z. T.L, ka qenë jashtë shtetit. Pa dyshim kjo gjë vë në pikëpyetje gjithë transaksionet e kryera në këtë llogari.
- Gjithsesi, sipas pretendimit të subjektit, edhe sikur të merret e mirëqenë se shuma e derdhur në këtë llogari në datën 3.3.2010 në vlerën 5,225 euro është me burim nga të ardhurat e subjektit dhe personit të lidhur, nga analiza financiare rezulton se ata kanë pasur mundësi që me të ardhura të ligjshme të depozitojnë në bankë vlerën 5,225 euro, sepse më 31.12.2009 kanë disponuar *cash* 700,000 lekë të deklaruara në DIPP-në e vitit 2009 dhe kjo shumë e dekluar *cash* është me burime të ligjshme, pasi në analizën financiare të rishikuar për vitin 2009 subjekti dhe personi i lidhur kanë rezultuar me balancë pozitive.
- Sa më sipër, Komisioni çmon se subjekti dhe personi i lidhur kanë kryer pagesën 10 mijë euro në fund të vitit 2010 dhe transfertat, derdhjet dhe tërheqjet në llogarinë e personit të lidhur nuk duhet të përfshihen në analizën financiare të vitit 2010 si shpenzime.

4. Tokë me sipërfaqe 500 m², ndodhur në *, Vlorë**

4.1 Personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, në deklaratën *Vetting*, si dhe në deklaratën e vitit 2014 ka deklaruar pasuri të paluajtshme (tokë) me sip. 500 m², në ***, përfituar në bazë të kontratës së dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.5.2014, me dhurues shtetasit N.H, V.H, V.H dhe A.H¹¹.

Faktet e rezultuara nga hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

4.2 Sipas kontratës së dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.5.2014, në cilësinë e dhuruesit janë shtetasit N.H, i përfaqësuar nga A.H, V.H e përfaqësuar nga A.H, V.H dhe E.L, në cilësinë e pranuesit të dhurimit. Pala dhuruese është përfaqësuese ligjore e palëve, që janë bashkëpronarë në masën N.H ¼ pjesë ideale dhe V.H ka në pronësi të saj ¾ pjesë ideale mbi një sipërfaqe toke pyll e kullotë me sipërfaqe 500 m², ndodhur në zonën kadastrale ***, ***, Vlorë, në vendin e quajtur “***”, me kufizimet përkatëse. Sipas kontratës së dhurimit, pala dhuruese ka dëshirë t’i dhurojë palës pranuese të gjithë parcelën e sipërpërmendur, ndaj dhe ka

¹¹ Bashkëlidhur deklaratës: kontratë dhurimi, ku z. E.L përfiton nga dhurimi tokë me sip. 500 m², ***, Vlorë; vërtetim hipotekor nr. ***, datë 3.4.2014, për pasurinë në z. k. ***, në ***, Vlorë, në parcelën “***”, një sipërfaqe pylli e kullotë prej 500 m² në emër të shtetasve N.H dhe V.H me ¼ dhe 1/3.

vendosur kështu. Pas përfitimit nga dhurimi, pala pranuese e dhurimit bëhet pronare e ligjshme e kësaj parcele. Pas firmosjes së kësaj kontrate dhe regjistrimit të saj në ZVRPP-në Vlorë, pala përfituese e dhurimit bëhet pronare e ligjshme e pronësisë.

4.3 Në lidhje me arsyet e dhurimit¹² të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar se bashkëshorti ka pasur njohje të hershme me shtetasin A.N.H, më pas me dy vëllezërit V.H dhe A.H. Në cilësinë e avokatit, bashkëshorti ka ofruar konsulencë juridike në lidhje me procesin e regjistrimit të pasurive të llojit tokë bujqësore, vendndodhja fshati ***, të trashëguara nga gjyshi i tyre, shtetasi S.H. Bashkëshorti ka ndjekur edhe procedurën e regjistrimit të pasurive pranë zyrës së regjistrimit Vlorë.

4.4 Në lidhje me këtë dhurim, subjekti ka depozituar pranë Komisionit deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.5.2024, të shtetasit A.H. Në këtë deklaratë, ky shtetas ka deklaruar se me avokat E.L ka njohje që në fëmijëri. Arsyeja e dhurimit të sipërfaqes prej 500 m² sipas kontratës së dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.5.2014, pjesë e pasurisë (tokë me sipërfaqe mijëra hektarë) që kanë trashëguar nga i ndjeri gjysh i tij, S.H, ka qenë vlerësim për konsulencën juridike dhe punën që avokati ka kryer në lidhje me regjistrimin e pronave të ndodhura në ***, Vlorë.

4.5 Në pyetësin nr. 3, subjektin i është kërkuar të depozitojë pranë Komisionit kontratën e shërbimit dhe faturën e shërbimit në lidhje me konsulencën ligjore të ofruar nga bashkëshorti i subjektin si avokat i familjes H.

4.6 Në përgjigje të kësaj pyetjeje, subjekti ka deklaruar se në rastin konkret, qoftë konsulencia juridike që u është ofruar nga bashkëshorti pjesëtarëve të familjes H, qoftë edhe ndjekja e procesit të regjistrimit të pronës, nuk ka pasur për qëllim marrjen e një shpërblimi, sepse në të kundërt do të ishte bashkëshorti që do të përcaktonte vleftën e shpërblimit për punën e kryer. Bashkëshorti i ka orientuar, sugjeruar, këshilluar, ndihmuar dhe fakti që disa vite më vonë nga ofrimi i konsulencës juridike është bërë ky dhurim, ka qenë në kontekstin e mirënjohjes.

4.7 Në përfundim të hetimeve, subjektin të rivlerësimit dhe personit të lidhur i është kërkuar të depozitojnë dokumentacion ligjor për të provuar ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie, të depozitojnë dokumentacionin ligjor provues të regjistrimit të pronës në emër të bashkëshortit të saj, dokumentacionin ligjor provues të regjistrimit të pronës në emër të familjes H pranë ASHK-së Vlorë, si dhe të depozitojnë foto aktuale të pronës në emër të bashkëshortit të saj.

Qëndrimi i subjektin të rivlerësimit

4.8 Subjekti pas kalimit të barrës së provës parashtron të njëjtat prova dhe argumente të dërguara gjatë procesit, si dhe foto të tokës, e cila rezulton se nuk është e zhvilluar¹³.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

4.9 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se toka bujqësore objekt analize vjen si pasojë e një akti dhurimi, i përpiluar me vullnetin e lirë të personave për shkak si të marrëdhënies me personin e lidhur, por dhe të ndihmës juridike që i ky i fundit i ka dhënë. Nga hetimi u provua se kjo pasuri nuk vjen si pasojë e një kontrate

¹² Pyetësin nr. 2.

¹³ Vendimi nr. ***, datë 9.9.2008 "Për njohjen e së drejtës të pronësisë, kthimit dhe kompensimit të pronës", me nr. *** prot., datë 9.9.2008, të Agjencisë së Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave, Zyra Rajonale Qarku Vlorë, me anë të të cilit u është njohur trashëgimtarëve të shtetasit S.H e drejta e pronësisë për sipërfaqen e përgjithshme 864 000 m², nga e cila 245 100 m² kullojë, 291 000 m² pyll, 55 000 m² truall, 272 900 m² tokë bujqësore, sipas parcelave respektive (gjithsej tetë fletë).

- Shkresa nr. *** prot., datë 14.09.2009, e Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Qarku Vlorë, drejtuar ZVRRP Vlorë dhe Zyrës Përmbartimore Vlorë (një fletë).

- Planvendosja e pronës (katër fletë).

- Vërtetim nga dokument hipotekor në emër të shtetasve V.H dhe N.H, lëshuar në datën 21.4.2014.

- Vërtetim nga dokument hipotekor në emër të shtetasit E.L, lëshuar në datën 27.5.2014.

shërbimi për të cilën personi i lidhur do të kishte detyrimin të paguante detyrimet tatimore. Ky qëndrim është koherent si në kontratën e dhurimit, në deklaratën noteriale, gjatë procesit, edhe në deklaratën e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit. Ky akt nuk përbën një rast konflikti interesi për subjektin dhe nuk ka asnjë element që mund të jetë një indicie për ndikimin e subjektit në këtë pasuri.

5. Automjet tip “**”, blerë me çmimin 980,000 lekë**

5.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar automjet tip “****”, me targë AA *** LF. Vlera: 980,000 lekë. Ndërsa bashkëshorti i subjektit në deklaratën *Vetting* deklaroi si burim krijimi për këtë pasuri “kursimet nga të ardhurat e përbashkëta”.

Faktet e rezultuara nga hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

5.2 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka depozituar kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.6.2010, lidhur midis shitësit L.S dhe blerësit E.L. Sipas kësaj kontrate, shitësi me vullnet të lirë deklaroi se ai i shet blerësit E.L makinën tip “****” për shumën 980,000 lekë. Blerësi E.L deklaroi se me vullnet të lirë do e bëjë pagesën me të regjistruar mjetin dhe se mjetin e ka marrë dorëzim duke mos pasur pretendime për gjendjen teknike të tij.

5.3 Në këtë kontratë shitjeje, shitësi përfaqësohet nga përfaqësuesja e tij, znj. Dh.M, me prokurën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.12.2008.

5.4 Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar, ndër të tjera, automjet tip “****”, vit prodhimi 2002, sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 30.6.2010, në vlerën 980,000 lekë. Burimi: Kursimet.

5.5 Gjatë hetimit administrativ, në pyetësorin standard, subjekti, në përgjigje të pyetjes për shpenzime të kryera me vlerë më të madhe se 2,500 euro, ndër të tjera ka deklaruar: *Shpenzim tjetër ka qenë për blerjen e automjetit tip “****”, me targa VL *** D, në bazë të kontratës së shitblerjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.6.2010, në shumën 980,000 lekë. Si burim financiar kanë qenë kursimet e mia nga paga e vitit 2008, në shumën 500,000 lekë dhe shuma e mbartur ka qenë e kursimeve të përbashkëta të vitit 2009 – 2010.*

5.6 DPSHTRR-ja me shkresën nr. *** prot., datë 26.1.2021, vendosi në dispozicion kopje të dosjes së automjetit me targë VL *** D, nga ku rezultoi se: (i) Me kontratën e shitblerjes datë 30.6.2010, bashkëshorti i subjektit ka blerë një automjet tip “****”, vit prodhimi 2002, me çmim 980,000 lekë, nga shitësi L.S, si dhe dokumentacionin e mjetit, si leja e qarkullimit, certifikatat e pronësisë, kontrolli fizik etj.

5.7 Nga deklarata doganore ***, datë 29.6.2010, rezultoi se ky mjet ka hyrë në Republikën e Shqipërisë nga shitësi L.S, i cili e ka blerë në Itali në vlerën 4,000 euro x 137,26 lekë = 548,040 lekë, plus shpenzimet e zhdoganimit në vlerën prej 397,651 lekë = 946,691 lekë. Bashkëshorti i subjektit e ka blerë këtë automjet me kontratë shitblerjeje në datën 30.6.2010.

Analizë e burimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie dhe mundësia financiare

5.8 Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2010, subjekti, si në deklaratë të interesave periodikë privatë 2010, ashtu edhe në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar “Kursimet *cash* të familjes”.

5.9 Nga leximi i deklaratave periodike, rezultoi se në DIPP-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar kursime *cash* në vlerën 500,000 lekë. Në vitin 2009 ka deklaruar si kursime *cash* vlerën 200,000 lekë. Në total, kursimet e akumuluar deri më 31.12.2009 janë në shumën 700,000 lekë. Këto kursime, së bashku me të ardhurat e vitit 2010, deri në momentin e kryerjes së pagesës janë përdorur si burim krijimi për automjetin dhe nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare për të paguar automjetin në datën 25.9.2010 për shkak të balancës negative.

Tabela nr. 4

Përshkrimi	1.1.2010 – 25.9.2010
Pasuritë	4,441,164
Dy apt. banimi, të bashkuara në 1, në bashkëpronësi me bashkëshortin me sip. 181.2 m ² , ***, Tiranë. Vlera 81,284 euro	4,163,100
Automjet tip “****” me targa AA *** LF, blerë 30.6.2010 (VL *** D)	980,000
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve</i>	(701,936)
Likuiditete në banka	5,646
<i>Cash deklaruar DPV</i>	-
Gjendja e likuiditeteve	5,646
Detyrime	3,563,700
Kredia NBG Bank sipas kontratës datë 11.1.2010	4,163,100
<i>Pagesë kësti (principali + interesi)</i>	(599,400)
Pasuri neto (pasuri - detyrime)	877,465
Të ardhurat	1,724,278
Të ardhurat nga paga subjekti	504,080
Të ardhurat nga leja e lindjes	112,448
Të ardhurat nga paga e bashkëshortit	0
Të ardhurat nga aktiviteti si avokat	1,107,750
Shpenzimet	3,533,798
Shpenzime jetike	307,395
Shpenzime udhëtimi	277,540
Shuma të shpenzuara sipas tërheqjeve bankare	2,948,863
Mundësia për kursime	-2,686,984

5.10 Në përfundim të analizës financiare të kësaj pasurie, Komisioni i dërgoi subjektit barrën e provës, ku duket se kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 2,686,984 lekë për blerjen e automjetit, për shkak të balancës negative.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

5.11 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, parashtron se referuar deklarimeve të kryera gjatë vitit 2010, përgjigjeve të dërguara ILDKPKI në vitin 2012, kur është përzgjedhur për kryerjen e verifikimit të pasurisë nëpërmjet shortit, deklaratës *Vetting* dhe përgjigjes së pyetësorit standard, si burim krijimi për blerjen e automjetit kanë shërbyer kursimet *cash* të disponuara të familjes. Komisioni ka kryer analizën financiare deri në datën 25.09.2010, duke përfshirë në këtë analizë dhe shumën prej 2,948,863 lekësh, që lidhet me kryerjen e transaksioneve në NBG Bank. Automjeti tip “****”, me targë AA *** LF, është blerë në datën 30.6.2010 dhe analiza financiare e kryer deri në këtë datë, sipas prapësimeve të subjektit paraqitet me balancë pozitive në shumën 130,743 lekë. Subjekti pretendon se në analizën financiare duhet të korrigjohet dhe zëri shpenzime udhëtimi.”

5.12 Në periudhën 1.1.2010 – 30.6.2010, subjekti dhe bashkëshorti kanë udhëtuar drejt SHBA-ve. Ky udhëtim është organizuar dhe mbuluar nga motra e bashkëshortit Xh.L, me shtetësi amerikane. Në këtë udhëtim kanë qëndruar në shtëpinë e shtetasit P.Q (daja i subjektit) me adresë në atë kohë: ***, USA. Ky fakt vërtetohet me deklaratën noteriale datë 18.10.2024 të shtetasit P.Q dhe deklaratën noteriale datë 17.10.2024 të shtetasit A.P.

5.13 Në lidhje me udhëtimin e kryer nga bashkëshorti i subjektit ndërmjet datave 8.7.2010 – 11.7.2010, për të cilin në pyetësonin standard është deklaruar udhëtim pune në ***, Itali, subjekti ka depozituar prokurë të përgjithshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.12.2009, të shoqërisë “****”, me administrator shtetasin F.Ç, deklarata noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.10.2024, e shtetasit Xh.Ç. Ky shtetas në cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k. ka konfirmuar se në muajin korrik të vitit 2010 babai i tij, shtetasi F.Ç, bashkë me avokatin E.L, përfaqësues ligjor të shoqërisë “****” sh.p.k., kanë udhëtuar së bashku me qëllim nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me shtetas italianë. Shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit janë mbuluar nga shoqëria “****” sh.p.k. Nga të dhënat e sistemit TIMS konfirmohet se në datën 8.7.2010 shtetasit F.Ç dhe E.L kanë udhëtuar drejt Italisë me automjetin me targë TR *** S në përdorim/pronësi të shtetasit F.Ç me tragetin e linjës *** nëpërmjet pikës së kalimit kufitar Porti Durrës.

5.14 Subjekti ngre të njëjtat pretendime lidhur me transaksionet e kryera në ABI Bank në vlerën 2,948,863 lekë, të analizuara këto në pikën 3 të këtij vendimi.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

5.15 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se duke pasur parasysh se:

- Transaksionet dhe tërheqjet në llogarinë bankare të ABI Bank nuk mund të përfshihen në analizën financiare të subjektit;
- Duke mos marrë në konsideratë pretendimet e subjektit për uljen e shpenzimeve të udhëtimeve të punës, pasi kanë mbetur në nivel deklarativ dhe jo të bazuara në akte që provojnë marrëdhënien e punësimit dhe parashikimin në të të pagesës së shpenzimeve të udhëtimit.
- Pagesa e kështit prej 10,000 euro është kryer në fund të vitit 2010.

5.16 Arrin në konkluzionin se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mundësi që të krijojnë këtë pasuri të luajtshme, pasi rezultojnë me një balancë pozitive në vlerën 486,686 lekë deri në datën e regjistrimit të mjetit 25.9.2010, datë në të cilën është likuiduar çmimi.

6. Pjesa takuese prej 1/8 e shumës prej 1,100,000 lekësh

6.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “Pjesa takuese në masën 1/8, në bazë të dëshmisë së trashëgimisë së nënës sime, E.F, të shumës prej 1,100,000 lekësh, të përfituar nga shitja e apartamentit të banimit me sipërfaqe 50 m² në ***, ****”.

6.2 Bashkëlidhur deklaratës, subjekti ka depozituar: kopje të kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.2.2016; certifikatë pronësie me nr. serie ***, datë 10.4.2012, të lëshuar nga ZVRPP ***; vendimin nr. ***, datë 6.3.2012, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë.

6.3 Subjekti ka deklaruar se kjo shumë lekësh nuk është tërhequr prej saj, por ka kaluar për llogari të babait, shtetasit K.F, në depozitën e hapur pranë Raiffeisen Bank.

6.4 Komisioni, bazuar në dokumentacionin ligjor, konstatoi se subjekti këtë shumë lekësh e përfiton si trashëgimtare e radhës së parë të nënës së saj, të ndjerës E.F. Znj. E.F, së bashku me bashkëshortin e saj, z. K.F, kanë qenë bashkëpronarë të një apartamenti me sip. 50 m² në qytetin e ***/****. Me vendimin për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të trashëgimlënës janë bashkëshorti dhe 3 fëmijët e saj, që përfitojnë 1/4 e pasurisë së të ndjerës. Pjesa takuese e subjektit është 1/8, por subjekti nuk e ka disponuar këtë shumë parash.

6.5 Komisioni nuk ka konstatuar ndonjë problematikë për këtë pasuri, që lidhet me procesin e rivlerësimit.

Gjetje të tjera

7. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me shkresën nr. *** prot., datë 26.1.2021, informon Komisionin se nga verifikimi në bazën digjitale të të dhënave të vetëdeklarimeve, subjektet e përmendura në shkresë rezultojnë aplikues në procesin e legalizimit: P.Xh.L dhe R.Th.K, regjistri i deklaratave nr. *** prot., datë 10.3.2014, ***, Vlorë.

7.1 Në pyetësin nr. 3, subjektit i është kërkuar të depozitohet në Komision dokumentacionin e aplikimit për legalizim dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie.

7.2 Gjatë hetimit, subjekti ka depozituar në Komision kopje të firmosur të deklaratës për përfshirje në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtim me leje të shtetasve R.Th.K dhe P.Xh.L, të datës 3.10.2014, të cilët deklarojnë se ndërtimi është kryer pa leje në vitin 2008, në fshatin ***, lagjja “****”, pranë vilave “****”. Gjithashtu, subjekti ka depozituar certifikata familjare të dy deklaruesve të ndërtimit pa leje, si dhe foto të objektit dhe dokumentacion financiar për të provuar të ardhurat e ligjshme nga punësimi në Itali të shtetasit P.L.

7.3 Në lidhje me ndërtimin pa leje në ***, aplikuar për leje legalizimi me dosjen nr. ***, datë 10.3.2014, nga shtetasit P.Xh.L dhe R.Th.K, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për marrëdhënien e vjehrit të saj me shtetasen R.Th.K dhe të japë informacion në lidhje me personin që ka investuar në ndërtimin e objektit, si dhe të depozitohet foto aktuale të tij.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

7.4 Subjekti ka parashtruar ndër të tjera se marrëdhënia civile që vjehri i saj ka krijuar në vitin 2008 me shtetasen R.K, është një marrëdhënie që nuk i përket as asaj dhe as bashkëshortit. Referuar çfarë i është komunikuar nga vjehrra se vjehri ka pasur marrëdhënie/njohje të hershme shoqërore me bashkëshortin e shtetasen R, aktualisht është e pamundur të marrë shpjegime prej tij, sepse ai është diagnostikuar me diagnozën “Memory Impairment” (dëmtim i kujtesës). Për sa i përket investimit në ndërtimin e objektit, subjekti gjykon se duhet të jetë i përbashkët.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

7.5 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se nuk rezultuan indicie apo prova që kanë të bëjnë me procesin e rivlerësimit të subjektit.

7.6 Nga të dhënat e QKB-së rezulton se bashkëshorti i subjektit ka deklaruar si adresë të ushtrimit të aktivitetit *lagjen “****”, pallati i ri “****”, përbri gjykatës, kati ****.

7.7 Në përfundim të hetimeve, subjektit iu kërkuar të provojë marrëdhënien e bashkëshortit të saj me adresën e deklaruar dhe të provojë me dokumentacion ligjor pronësinë e kësaj adrese, si dhe kostot e përdorimit të këtij ambienti nga ana e bashkëshortit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

7.8 Subjekti i rivlerësimit shpjegon ndër të tjera se personi i lidhur ka ushtruar profesionin e avokatit dhe se kjo adresë ka qenë e destinuar për këtë veprimtari. Kjo njësi shërbimi ka qenë në pronësi/posedim të shtetasit K.Z, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Midis tyre nuk është lidhur një kontratë qiraje për shkak të kohëzgjatjes njëvjeçare, vlera e qirasë ka qenë dhjetë mijë lekë në muaj dhe pagesat janë kryer në *cash*. Në vijim, aktivitetin e tij e ka ushtruar në zyrën që disponon aktualisht me qira. Kontrata e qirasë është lidhur për një afat trevjeçar, me të drejtë rinovimi e pëlqim të palëve. Marrëdhënia e qirasë ka vijuar edhe pas vitit 2018, megjithëse ndërmjet tyre

nuk është lidhur një tjetër kontratë. Vlera e qirasë e përcaktuar shprehimisht në kontratë është njëzet e pesë mijë lekë¹⁴.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

7.9 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se nuk rezultuan indicie apo prova që kanë të bëjnë me procesin e rivlerësimit.

7.10 Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* kursime *cash*.

7.11 Subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar kursime *cash* ndër vite, si më poshtë:

- Subjekti deklaron në DIPP të vitit 2008: “Kursime nga paga vjetore e vitit 2008. Shuma 500,000 lekë”, ndërsa bashkëshorti i saj deklaron: “Kursime 30,000 euro”.

Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti deklaron: “Kursime nga paga vjetore e vitit 2008. Shuma 200,000 lekë.”

Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti deklaron: “Kursime nga të ardhurat vjetore. Shuma 100,000 lekë.”

Në deklaratat periodike 2012 – 2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar ndryshime (shtesa/pakësime) apo gjendje *cash*.

7.12 Në përfundim, nga leximi i deklaratave periodike dhe shpjegimeve të dhëna në pyetësorë, rezulton se gjendja *cash* e akumuluar deri në datën 31.12.2016 duket se është në vlerën 100,000 lekë.

7.13 Subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për mospërputhjen e gjendjes së akumuluar që rezulton nga deklaratimet periodike me gjendjen në deklaratën *Vetting*.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

7.14 Pas kalimit të barrës së provës, subjekti sqaron Komisionin se shtesa e kursimeve *cash* në shumën 100,000 lekë, e deklaruar në DPV-në e vitit 2011, është pakësuar në fund të vitit 2013 për kryerjen e pagesës me shumën e mbetur pa paguar të apartamenteve, 1,284 euro. Në DPV-në e vitit 2013 nuk ka deklaruar pakësim të saj.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

7.15 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se parashtrimet e subjektit janë bindëse dhe duhet të reflektohen në analizën përfundimtare të subjektit të rivlerësimit.

8. Analiza paraprake e treguesve financiarë

8.1 Nga analiza e përgjithshme paraprake e kryer nga Komisioni e treguesve financiarë¹⁵, për periudhën nga fillimi i detyrës deri në datën 31.12.2016, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, si dhe në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur (bashkëshortit), përveç sa pasqyruar/analizuar më lart, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të dokumentuara për blerje/krijim të pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara, pasi ka rezultuar me balancë negative në shumën -10,336,555 lekë.

¹⁴ Subjekti ka vënë në dispozicion kopje të kontratës së qirasë dhe dokumentacionin pjesë përbërëse të kontratës, që vërteton posedimin ligjor të qiradhënsit për objektin njësi shërbimi, si dhe foto të një mandati të pagesës së qirasë, që është bërë në datën 11.2.2021 në Bankën Kombëtare Tregtare.

¹⁵ Bashkëlidhur në aneks të këtij relacioni gjendet analiza paraprake financiare së bashku me shpjegimet përkatëse.

8.2 Për sa më sipër, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumente në lidhje me konstatimet e bëra nga Komisioni.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

8.3 Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur të gjitha pretendimet, të cilat janë analizuar gjatë arsyetimit të vendimit përgjatë analizës së aseteve të deklaruara në deklaratën *Vetting* dhe gjetjet e rezultuara gjatë hetimit administrativ.

8.4 Subjekti ka parashtruar se në analizën financiare duhet të korrigjohen disa zëra, konkretisht: (i) Në vitin 2008 duhet të përfshihen të ardhurat nga bashkëshorti para martesë në shumën 5.505.366 lekë (sa është gjendja e likuiditeteve në bankë dhe gjendja *cash* deklaruar nga bashkëshorti, në totalin 40,000 euro); (ii) Të ardhurat që ka realizuar bashkëshorti gjatë vitit 2009 për shkak të ushtrimit të profesionit të avokatit. Me shkresën nr. *** prot., datë 23.10.2024, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Vlorë, ka informuar se: subjekti E.L rezultoi i regjistruar në QKB me NIPT *** me aktivitet avokat. Nga të dhënat që disponohen në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, Bashkia Vlorë, për vitin 2009, xhiroja e vlerësuar është në shumën 2,100,000 lekë, taksa e biznesit të vogël 11,800 lekë dhe taksat vendore 53,000 lekë. Për të përlloritur fitimin neto për vitin ushtrimor 2009, bazuar në qarkullimin e deklaruar dhe marzhin e fitimit 80%¹⁶, fitimi neto do të rezultonte në vlerën 1,680,000 lekë; (iii) Në analizën financiare të vitit 2010 duhet të paraqitet pagesa *cash* 10,000 euro e kryer në momentin e dorëzimit të apartamentit në fund të vitit 2010; (iv) Në vitin 2013 duhet të përfshihet pagesa e shumës 1,284 euro si këst përfundimtar i likuiduar për blerjen e apartamenteve, pasi në momentin e rakordimit shoqëria ka lëshuar mandatarkëtimin për shumën 11,284 euro si detyrim i kërkuar nga noteri për dokumentimin e transfertave të kryera në lidhje me porositjen e apartamenteve dhe, për rrjedhojë, në vitin 2014 nuk duhet të përfshihet në analizë pagesa 11,284 euro sipas mandatarkëtimin të ndodhur në dosjen e regjistrimit të apartamenteve në ASHK. Ky mandatarkëtim është nënshkruar midis palëve për të dokumentuar pagesën e shumës dhe detyrimin e likuidimeve të kryera që kërkohehin të bashkëlidheshin me kontratën përfundimtare të shitblerjes. Sipas kontratës së prenotimit, pagesa në shumën 11,284 euro ishte detyrim të likuidohej në momentin e dorëzimit të apartamentit dhe jo në momentin e marrjes së certifikatës së pronësisë. Apartamenti, referuar edhe konfirmimeve nga FSHU-ja dhe UKT-ja, rezultoi se është dorëzuar në vitin 2010 dhe në fund të këtij viti kanë likuiduar shumën 10,000 euro, duke mbetur pa likuiduar një vlerë e vogël që lihet gjithmonë pa paguar deri në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitblerjes; (v) Për vitin 2013, në analizën financiare duhet të përfshihet shuma e arkëtuar nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor në lidhje me shpërblimin e caktuar nga gjykata në shumën 384,921 lekë për largimin në mënyrë të padrejtë nga puna të bashkëshortit. Komisioni nuk e ka përfshirë në analizën financiare, sepse ka vlerësuar se nuk vërtetohet ekzekutimi i tij. Me vërtetimin e përmbledhur gjyqësor B.M të datës 30.10.2024, si dhe gjithë dokumentacionin e praktikës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 22.5.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 6.5.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë), që tregon pushimin e ekzekutimit dhe arkëtimin e shumës nga ASHK-ja, vërtetohet se ka shlyer *cash* bashkëshortin për shumën 384,921 lekë; (vi) Në vitin 2013 është pakësuar gjithashtu gjendja *cash* e disponuar në shumën 100,000 lekë, deklaruar si shtesë në DPV-në e vitit 2011; (vii) Vlera e shpenzimeve të

¹⁶ Në jurisprudencën e Kolegjit, marzhi i fitimit për aktivitetin e avokatit është vlerësuar 80%. Referuar vendimit nr. 20/2023, paragrafi 12.17; vendimit nr. 33/2021, paragrafi 30.

udhëtimit, duke i reduktuar ato me shpenzimet për udhëtimet e punës të mbuluara nga klientët dhe shpenzimet e qëndrimit të të afërmit, për të cilat subjekti ka depozituar deklaratat noteriale.

8.5 Subjekti ka parashtruar se Komisioni nuk ka vlerësuar dokumentacionin ligjor që është dorëzuar në përgjigje të pyetësorit nr. 2, që ka konfirmuar marrëdhënien e punës të bashkëshortit me klientët e tij, si dhe deklaratat noteriale të klientëve dhe të afërmeve të tyre, që janë dorëzuar në funksion të konfirmimit të kësaj marrëdhënieje pune që ka passjellë dhe mbulimin e shpenzimeve për udhëtimet e punës të realizuara jashtë shtetit.

8.6 Gjithashtu janë dorëzuar edhe deklarata noteriale për shpenzimet e qëndrimit jashtë shtetit tek familjarët dhe të afërmit e tyre (deklarata noteriale nr. *** rep., nr *** kol., datë 24.10.2024, e shtetasit R.D; deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.10.2024, e shtetasit E.T; deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.10.2024, e shtetasit Xh.C; deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.10.2024, e shtetasit Y.H; deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.10.2024, e shtetasit Sh.G; deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.10.2024, e shtetasit E.B; deklarata datë 25.10.2024 e shtetasës G.F, avokate me nr. licence Dhoma e Avokatisë *** ***; deklarata datë 27.10.2024 e shtetasit Th.Q; deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.11.2024, e shtetasës L.L; deklaratë e hartuar nga agjencia detare “****” sh.p.k.; deklaratë e hartuar nga agjencia detare “****” sh.p.k.)

8.7 Duke marrë në konsideratë sa më sipër, subjekti sqaron se rezulton me një balancë negative prej -1,091,422 lekësh, që vjen si rrjedhojë e flukseve monetare të bashkëshortit nga aktiviteti i tij si person fizik. Në mungesë të pasqyrave financiare është marrë në konsideratë vetëm fitimi neto i realizuar, ndërkohë bashkëshorti ka pasur mundësi si fluks monetar të një vlerë më të lartë për shkak të garancive, parapagimeve të kryera nga klientët për procese gjyqësore të caktuara.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

8.8 Komisioni, pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit dhe provat e depozituara prej tij, arriti në konkluzion se ato kanë nivel besueshmërie dhe provueshmërie të mjaftueshëm. Këto vlerësime të Komisionit, të trajtuara gjerësisht më lart, u reflektuan në analizën financiare, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pamundësi financiare në vlerën totale -1,540,670 lekë.

Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e pasurisë

- i. Nga hetimi administrativ i kryer dhe shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në këtë kuadër rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Ajo ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të saj. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Eranda Laze, nuk vërtetohen shkaqe që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.
- iii. Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë e konstatuara dhe balancat negative të fondeve të rezultuara nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, Komisioni gjatë hetimit administrativ konstatoi se pasaktësitë e konstatuara dhe balancat negative të fondeve nuk kanë ndikuar në mënyrë thelbësore në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit.
- iv. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaratimet e pasakta të konstatuara si më sipër dhe problematikat e evidentuara në analizën financiare nuk çmohen të

mjaftueshme për cenimin e kriterit të pasurisë apo të vlerësohen si të tilla që të ndikojnë në vlerësimin tërësor në procesin e rivlerësimit të kryer për këtë subjekt. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut të drejtësia, pasi vlerësimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit.

- v. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Eranda Laze, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

9. AKSIK-ja, si institucioni kompetent për kontrollin e figurës, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, si dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka paraqitur pranë Komisionit raportin fillestar nr. *** prot., datë 2.11.2017, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga ky subjekt rivlerësimi.

9.1 AKSIK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 27.5.2024, informon se Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvleftësimit të Informacionit të Klasifikuar, me vendimin nr. ***, datë 23.5.2024, ka vendosur deklasifikimin plotësisht të raportit nr. *** prot., datë 2.11.2017.

9.2 AKSIK-ja me shkresën nr. *** prot., datë 27.5.2024, ka përcjellë raportin e deklasifikuar plotësisht¹⁷, ku informon se:

- Formulari i deklaramentit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë, në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016.

- Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës. Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të kimit të organizuar.

9.3 Sa më sipër, grupi i punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Eranda K. Laze.

9.4 Bazuar në informacionet e ardhura nga institucionet verifikuese në kohështrirje gjatë periudhës së rivlerësimit, rezulton se për subjektin e rivlerësimit, znj. Eranda K. Laze, nuk administrohen informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për përfshirje në veprimtari të paligjshme.

9.5 Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit. Nga të dhënat e sistemit TIMS dhe ato të deklaruara nga subjekti në pyetësonin standard, ka rezultuar se ajo ka udhëtuar me shtetasin A.M dhe bashkëshorten e tij në datën 8.11.2015 dhe bashkëshorti i subjektit ka udhëtuar me këtë shtetas më 19.2.2016.

9.6 Subjekti është pyetur se çfarë lidhje ka me këta shtetas. Në përgjigjen e saj në pyetësonin nr. 3, subjekti ka sqaruar se ka njohje shoqërore me bashkëshorten e shtetasit A.M, shtetasen V.M. Kjo shtetase ushtron detyrën e noteres që prej vitit 2014. Njohja ka lindur kur kanë udhëtuar së bashku në muajin nëntor të vitit 2015. Arsyeja e udhëtimit nga data 4.11.2015 deri në datën 8.11.2015 ka qenë udhëtim pune në Itali i bashkëshortit. Në këtë udhëtim pune të bashkëshortit, kanë qenë dhe shtetasit A.M dhe V.M dhe udhëtimi është kryer me automjetin në përdorim të tyre. Udhëtimi që bashkëshorti ka kryer me shtetasin A.M në datën 9.2.2016, është bërë për arsye pune.

¹⁷ Vendim i KDZH-së nr. 202, datë 23.5.2024.

9.7 Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar¹⁸ informon se në lidhje me shtetasin A.M, në ish-Prokurorinë e Krimeve të Rënda është regjistruar procedimi penal nr. ***, viti 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2¹⁹ i Kodit Penal. Pas kryerjes së hetimeve në lidhje me këtë procedim penal, është vendosur shpallja e moskompetencës dhe kalimi i akteve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, datë 26.6.2018.

9.8 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë²⁰ informon se:

- A.M, regjistruar procedimi penal në ish-Krimet e Rënda me nr. ***, viti 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a-2 i Kodit Penal, i cili është transferuar pranë Prokurorisë Vlorë me nr. *** për veprën penale të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal²¹, e cila në përfundim të hetimeve është dërguar me kërkesë për miratim të marrëveshjes penale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

- Procedimi penal nr. *** për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, e cila në përfundim të hetimeve është dërguar me kërkesë për pushim të çështjes penale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

9.9 Në kërkesën e datës 27.7.2021 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në pikën 2 të saj, prokurori konstaton: *Sikurse rezultoi në fazën e hetimit paraprak ndaj shtetasit A.M, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë ka regjistruar procedimin penal me nr. ***, datë 15.8.2012, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Për këtë procedim penal me vendimin e datës 23.7.2015 është disponuar për pushimin e çështjes në mbështetje të neneve 24/2 dhe 328, pika 1, shkronja “b”, dhe nenit 329 të Kodit të Procedurës Penale, pasi fakti i referuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.*

9.10 Referuar ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 3 të tij, në pikën 15 parashikohet: *Person i përfshirë në krimin e organizuar është çdo person që është dënuar apo proceduar penalisht brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë.*

9.11 Referuar procedimit penal nr. *** të vitit 2012, rezulton se shtetasi A.M është proceduar nga ana e Prokurorisë së Rrethit Vlorë për një nga veprat penale të parashikuara nga në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar. Pavarësisht se procedimi penal është pushuar, shtetasi A.M, bazuar në pikën 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, konsiderohet person i përfshirë në krimin e organizuar.

9.12 Në deklaratën për kontrollin e figurës, në rubrikën “Të dhëna për sigurinë”, në pikën c, në lidhje me pyetjen se a ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e një takimi, komunikimi elektronik ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi e qëllimshme me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës, subjekti është përgjigjur me “Jo”.

¹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 27.6.2024, e SPAK-ut.

¹⁹ Neni 283/a -Trafikimi i narkotikëve “Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi, në kundërshtim me ligjin, i substancave narkotike ose psikotrope, si dhe i farërave të bimëve narkotike, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet. Organizimi, drejtimi ose financimi i kësaj veprimtarie dënohen me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet”.

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 19.9.2024.

²¹ Neni 300 i Kodit Penal – moskallëzim krimi.

9.13 Neni DH i Aneksit të Kushtetutës përcakton kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Qëllimi i dispozitës kushtetuese është të identifikojë ato subjekte të cilat kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

9.14 Nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

9.15 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, nga ku duket se shtetasi A.M hyn në rrethin e personave të përfshirë në krimin e organizuar dhe duhet të ishte deklaruar në deklaratën e kontrollit të figurës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

9.16 Subjekti pas kalimit të barrës së provës deklaroi se në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit të pushimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, datë 23.7.2015, për procedimin penal nr. *** të vitit 2012, të regjistruar për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, është arsyetuar ndër të tjera: *Për të provuar faktin nëse personat objekt i verifikimit pasuror apo personat e lidhur me ta, në kuptim të nenit 3/2 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, kanë qenë të dënuar më parë, janë kërkuar dhe administruar vërtetimet e gjendjes gjyqësore për shtetasit A.M, V.M, L.M, K.M dhe R.M. Nga administrimi i vërtetimeve të gjendjes gjyqësore rezulton se asnjë prej shtetasve të mësipërm nuk rezulton që të ketë qenë i dënuar më parë. Nga informacioni i administruar prej Zyrës Italiane të Bashkëpunimit Policor në Shqipëri INTERFORZE, rezulton se në arkivin e tyre të të dhënave nuk rezulton asnjë e dhënë në ngarkim të subjektit me gjeneralitetet A.M.*

Për të sqaruar rrethanat e hetimit është pyetur në cilësinë e deklaruësit shtetasi A.M.

Në rastin objekt hetimi u provua se shtetasi A.M është person i padënuar më parë, si dhe nuk disponohen të dhëna për përfshirjen e tij në ndonjë veprimtari kriminale. Për rrjedhojë, pasuria e disponuar prej tij nuk mund të provohet se është produkt i ndonjë vepre penale të kryer prej këtij shtetasi apo personave të tjerë, pasi ai rezulton i padënuar më parë. Gjithashtu rezulton e provuar se edhe familjarët e këtij shtetasi nuk janë dënuar për ndonjë vepër penale, nga e cila mund të rrjedhin pasuri apo produkte të veprës penale. Nuk është siguruar asnjë e dhënë që shtetasi A.M të jetë përfshirë në ndonjë veprimtari kriminale.

Subjekti në vijim ka shpjeguar se nga përmbajtja e fashikullit të procedimit penal rezulton se shtetasit A.M nuk i është atribuar nga organi procedues kryerja e ndonjë vepre penale, emri i tij nuk është regjistruar në regjistrin e veprave penale të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ky shtetas nuk është pyetur asnjëherë si “person ndaj të cilit zhvillohen hetimet” dhe nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit dhe as nuk është ndaluar apo arrestuar për kryerjen e ndonjë vepre penale. Në mbështetje të provueshmërisë të këtij konstatimi, subjekti ka dorëzuar vërtetimin nr. *** prot., datë 24.10.2024, të lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. Vetë organi procedues ka konkluduar se nuk disponon të dhëna për përfshirje të tij dhe të familjarëve të tij në ndonjë aktivitet kriminal, të dhëna këto që janë konfirmuar edhe nga Zyra Italiane e Bashkëpunimit Policor në Shqipëri INTERFORZE.

Vlerësimi i Komisionit për shtetasin A.M si kontakt i papërshtatshëm në raport me subjektin e rivlerësimit, vetëm se ekziston procedimi penal në fjalë, me të dhënat, përmbajtjen dhe konkluzionet e bëra nga organi procedues, Prokuroria e Rrethit Vlorë, sipas akteve të vetë dosjes, është i pabazuar në ligj dhe në praktikën gjyqësore të zhvilluar nga gjykatat më të larta në vend dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, lidhur me kuptimin e “kontaktit të papërshtatshëm”. Analizimi dhe thellimi në të dhënat e akteve prokuroriale, tregon qartë se

A.M në kuptim dhe zbatim të ligjit nuk mund të konsiderohet si kontakt i papërshtatshëm dhe, për rrjedhojë, e gjithë kjo të afektojë figurën e subjektit të rivlerësimit.

Subjekti ka shpjeguar gjithashtu se njohja me bashkëshorten e shtetasit A.M, shtetasen V.M, që ushtron aktivitetin e noteres që prej vitit 2015, ka ndodhur për rrethana krejt rastësore të punës së bashkëshortit të saj. Bashkëshorti, duke qenë se që prej vitit 2009 ushtron në mënyrë të vazhduar profesionin e avokatit, për shërbimin ndaj një prej klientëve të tij, me vendbanim në Itali, i është nevojitur dhe shërbimi ndërkohë i një tjetër profesioni të lirë, si noteria. Për të dhënë shërbimin në fjalë për klientin u duhej të udhëtonin së bashku për në Itali dhe kjo ka qenë arsyeja që noterja, të cilën deri atëherë unë nuk e njihja, ka vendosur që të shoqërohet në këtë udhëtim nga bashkëshorti i saj. Ia ka njoftuar këtë gjë bashkëshortit të subjektit dhe ky i fundit, që të mos mbetej vetëm në shoqërinë e një çifti tjetër bashkëshortësh, i ka propozuar subjektit të rivlerësimit që ta shoqërojë...

Në këtë udhëtim ka qenë edhe një prej fëmijëve të subjektit, në atë kohë i moshës 4 vjeç. Ky udhëtim i përbashkët, i lindur në rrethana krejt rastësore, ishte për shkak të punës së bashkëshortit dhe njëkohësisht dhe takimit ku unë pashë dhe takova për herë të parë noteren M dhe bashkëshortin e saj...

Subjekti ka shpjeguar se në muajin nëntor të vitit 2015 (koha e kryerjes së udhëtimit) nuk kishte dijeni për ekzistencën e një çështjeje penale të vitit 2012, të filluar tri vite më parë, një çështje e pushuar dhe pa shënime në regjistër të emrit të personit në fjalë, madje në vitin 2012 e në vijim, si subjekti, si bashkëshorti i saj, nuk kishin asnjë lloj njohjeje me shtetasin A.M.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

9.17 Trupi gjykues, pasi administroi provat e rezultuara gjatë hetimit, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në prapësimet e tij me shkrim dhe në seancën dëgjimore, konstaton se:

Referuar pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, shtetasi A.M nuk është i dënuar dhe as i proceduar penalisht për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, pasi ky person nuk është në cilësinë e personit nën hetim dhe nuk është marrë si i pandehur. Sipas fletës së regjistrimit të veprave penale, rezultoi se emri i shtetasit A.M nuk është regjistruar si person nën hetim. Fakti i mosregjistrimit të shtetasit A.M në regjistrin e veprave penale në cilësinë e personit të proceduar penalisht nuk e bën atë ligjërisht një kontakt të papërshtatshëm për subjektin e rivlerësimit, duke përjashtuar kështu detyrimin e subjektit për ta deklaruar si kontakt të papërshtatshëm në deklaratën e kontrollit të figurës, aq më tepër e ndodhur kjo tri vite para se të kryhej ky udhëtim.

9.18 Trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit janë bindëse.

9.19 Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Eranda Laze, ka plotësuar në mënyrë korrekte deklaratën për kontrollin e figurës, pavarësisht dijenisë ose jo të saj lidhur me procedimin penal nr. *** të vitit 2012 për veprën “Pastrimi i produkteve të veprës penale”. Formalisht, emri i shtetasit A.M nuk figuron si person i regjistruar në regjistrin e veprave penale si autor i veprës penale dhe, për pasojë, ai nuk mund të konsiderohet si kontakt i papërshtatshëm në kuptim të pikës 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”.

9.20 Nga ana tjetër, udhëtimi i subjektit me persona të cilët mbrohen nga bashkëshorti i saj si avokat, tregon që subjekti i rivlerësimit duhet të tregojë një kujdes të shtuar lidhur me këtë fakt me qëllim eliminimin e këtyre situatave, të cilat në dukje mund të sjellin probleme lidhur me etikën e një magjistrati, pavarësisht faktit se në asnjë rast nga hetimi nuk rezultoi që subjekti të ketë vepruar në gjendje konflikti interesi.

Konkluzion i Komisionit për kontrollin e figurës

9.21 Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Eranda Laze, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

10. Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale pranë KLP-së, si organi ndihmës i vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, me short; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore – ka përpiluar një raport me qëllim analizimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, znj. Eranda Laze.

10.1 Sipas raportit profesional, subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi shumë të mira në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi, në veçanti të legjislacionit penal. Përdor arsytim të qartë dhe lidh drejt normën ligjore me zbatimin e saj në rastin konkret të hetimit. Nga analiza e dokumenteve ligjore të vëzhguara subjekti shfaq aftësi në arsytim ligjor. Tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej saj të paraqiten të strukturuar, me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore dhe etike.

10.2 Nga gjetjet në dokumentet ligjore të vëzhguara rezulton se nga ana e subjektit tregohet vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke u dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara. Konstatohet se subjekti ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës. Subjekti i rivlerësimit kryen veprime procedurale hetimore produktive. Prokurorja ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së një rregulli të mirëpërcaktuar në tri dokumentet e paraqitura nga vetë ajo dhe pesë dosjet e përzgjedhura bazuar në sistemin rastësor.

10.3 Komisioni gjatë hetimit konstatoi se:

- Nga të dhënat e sistemit TIMS ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj në muajin qershor 2022 kanë udhëtuar me një automjet që ka qenë në përdorim të shtetasit A.H. Bashkëshorti i saj ka udhëtuar disa herë me këtë shtetas gjatë periudhës kohore 2017 – 2020.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti në pyetësin nr. 3, ndër të tjera, ka shpjeguar se nuk e njeh personalisht shtetasin A.H. Arsyeja e të vetmit udhëtim në datën 26.6.2022 me automjetin që drejtohej nga bashkëshorti i saj është shoqërimi i të afërmeve, të cilët udhëtonin se bashku me ta nga SHBA drejt Shqipërisë. Për këtë subjekti është shprehur: *Bashkëshorti ka marrë në përdorim nga shtetasi A.H automjetin. Me shtetasin A.H bashkëshorti ka pasur dhe ka marrëdhënie pune. Udhëtimet e tij me këtë shtetas kanë qenë të shpeshta për shkak të ndjekjes së procesit gjyqësor në Itali të vëllezërve të tij. Bashkëshorti, për shkak të njohjes profesionale me avokatë në fushën e së drejtës, i ka sugjeruar përfaqësues ligjorë, ka pasur takim në institucionin ku ndodhej i paraburgosur në Itali shtetasi M.H, ka marrë pjesë në procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj tij në Itali. Bashkëshorti i ka përfaqësuar edhe në proceset gjyqësore që janë zhvilluar ndaj tyre në Tiranë dhe Vlorë²².*

Komisioni, referuar burimeve të hapura në media, ka konstatuar se shtetasi A.H akuzohet për trafik ndërkombëtar droge https://www.***

²² Bashkëlidhur subjekti ka dërguar në Komision kopje të prokurave të përfaqësimit të anëtarëve të familjes H nga ana e bashkëshortit të saj, si dhe *email* të avokatëve italianë me bashkëshortin e saj.

Nga informacioni i marrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezulton se për shtetasin A.H është regjistruar procedimi penal nr. ***, për veprën penale të parashikuar nga nenet 274²³, 242²⁴ të Kodit Penal, për të cilën në përfundim të hetimeve është vendosur me vendim pushimi.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me shkresën nr. ***, datë 27.6.2024, ka informuar se ndaj shtetasit A.H nuk ka pasur dhe nuk ka të regjistruar çështje penale.

- Nga të dhënat e sistemit TIMS ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë udhëtuar në disa raste me vëllain e E.Xh, shtetasin E.Xh. Shtetasi E.Xh ka depozituar 500 euro në llogarinë e bashkëshortit të subjektit në datën 31.1.2019.

Nga të dhënat e mediave të hapura rezulton se shtetasi E.Xh është hetuar për trafikim të lëndëve narkotike nga shteti italian https://www.***.

Është pyetur subjekti se cila është marrëdhënia me shtetasit E.Xh dhe E.Xh.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se bashkëshorti i saj me shtetasin E.Xh janë shokë, janë marrë të dy me sport që në adoleshencë dhe vijnë shoqërinë. Shtetasi E.Xh është vëllai i shtetasit E.Xh dhe bashkëshorti ka pasur edhe me të raport shoqëror. Me shtetasin E.Xh ka udhëtuar vetëm një herë dhe në këtë udhëtim kanë qenë dy çifte së bashku. Ky udhëtim i referohet periudhës 23.5.2019 – 27.5.2019.

Me shkresën nr. *** prot., datë 19.9.2024, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë informon se për shtetasin E.Xh është regjistruar procedimi penal nr. *** për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal²⁵, se në regjistrin e njoftimeve të veprave penale nuk ka të regjistruar emër personi nën hetim dhe se ky procedim aktualisht është në proces hetimi.

10.4 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë shpjegime në lidhje me: i) përdorimin e automjetit të personit të proceduar penalisht; ii) shoqërimin me persona me precedentë penalë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

10.5 Subjekti pas kalimit të barrës së provës ka deklaruar se në lidhje me informacionin në media, sipas të cilit është konstatuar se shtetasi A.H është akuzuar për trafik ndërkombëtar droge, ndërsa shtetasi E.Xh është hetuar për trafikim të lëndëve narkotike nga shteti italian, nuk qëndron. Nëse çdo informacion i marrë nga mediat online do të vlerësohej *apriori* si i vërtetë, eventualisht cilido shtetas do të mund të cenohej.

10.6 Subjekti pretendon se sa i përket faktit të regjistrimit të një procedimi penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë në vitin 2021, ky procedim penal është regjistruar dy vite më vonë nga koha kur ajo dhe bashkëshorti kanë udhëtuar me shtetasin E.Xh dhe bashkëshorten e tij në vitin 2019. Udhëtimi në vitin 2019 ka qenë i vetmi udhëtim në shoqërinë e personit në fjalë. Me shtetasin E.Xh nuk ka pasur dhe nuk ka asnjë lloj kontakti, komunikim apo lidhje me të.

Shtetasit A.H, E.Xh dhe E.Xh rezultojnë me gjendje gjyqësore të padënuar më parë dhe dyshimi që është ngritur ndaj tyre, si persona me precedentë penalë në kuptim të ligjit penal, nuk qëndron.

10.7 Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me shkresën nr. ***, datë 27.6.2024, ka informuar se ndaj shtetasve E.Xh dhe E.Xh nuk ka pasur dhe nuk ka të regjistruar çështje penale.

²³ Neni 274 - Prishja e qetësisë publike.

²⁴ Neni 242 - Mosbindja ndaj urdhrat të policisë së rendit publik.

²⁵ Neni 287 i Kodit Penal “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”.

10.8 Si konkluzion, përgjatë gjithë jetës së saj profesionale edhe jo vetëm subjekti ka qenë korrekte me punën dhe marrëdhëniet me njerëzit.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

10.9 Trupi gjykues, pasi administroi provat e rezultuara gjatë hetimit, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në prapësimet me shkrim dhe në seancën dëgjimore, konstaton se:

10.10 Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur dijeni mbi pronësinë e automjetit me të cilin ajo dhe familjarë të saj kanë udhëtuar për në Itali. Gjithashtu, nga dokumentacioni i dorëzuar në Komision nuk është konstatuar që shtetasi A.H të ketë precedentë penalë. Gjithashtu, në momentin e udhëtimit me shtetasin E.Xh dhe bashkëshorten e tij në vitin 2019, ndaj tij nuk ka pasur të regjistruar asnjë procedim penal në ngarkim të tij. Procedimi penal është regjistruar dy vite më vonë nga momenti i udhëtimit.

10.11 Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit duhet të tregojë kujdesin e nevojshëm në lidhje me rrethana që mund t'i sjellin cenim të etikës profesionale. Subjekti duhet të shmangë çdo situatë në dukje apo drejtpërdrejt që cenon angazhimin ndaj vlerave profesionale në lidhje me etikën dhe integritetin gjatë ushtrimit të funksionit.

10.12 Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi edhe 5 denoncimet e depozituara në Komision nga publiku. Në analizën e kryer rezultoi se tri prej tyre nuk u morën në vlerësim, pasi nuk përmbushnin kriteret e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ndërsa i kërkoi subjektit shpjegime për dy denoncime, e konkretisht për denoncimin e shtetasit I.Z²⁶ dhe shtetasës F.A²⁷.

10.13 Në lidhje me denoncimin e shtetasit I. Z., Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime për veprimet hetimore të kryera pas vendosjes nga gjykata të prishjes së vendimit për pezullimin e hetimeve, për procedimin penal nr. ***, regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal dhe vazhdimin e hetimeve.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

10.14 Subjekti me anë të prapësimeve të depozituara pranë Komisionit dhe të cituara gjatë seancës dëgjimore ka dhënë shpjegime në lidhje me kryerjen e veprimeve hetimore për këtë çështje, si dhe statusin aktual të saj. Subjekti ka shpjeguar se në aktet e dosjes përkatëse rezulton se vendimi i Gjykatës nr. ***, datë 26.2.2018, është komunikuar në datën 12.4.2018 në sekretarinë e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor. Në këtë dëftesë, veç shënimeve të bëra nga drejtuesi i prokurorisë dhe drejtuesi i seksionit, nuk ka asnjë shënim të subjektit se kur ajo ka marrë dijeni efektivisht. Ky vendim është marrë nga gjykata në dhomë këshillimi, pa praninë e subjektit si palë dhe nuk ka pasur dijeni për një vendimmarrje të tillë para njoftimit të vendimit. Subjekti ka konstatuar nga aktet e dosjes se në datën 23.7.2018 është kërkuar prej saj administrimi i fashikullit përkatës dhe njëkohësisht i është kërkuar shoqërisë “***” nëse ekzistonte mundësia e identifikimit të gjurmës së gjetur në vendin e ngjarjes, edhe pse për shkak të eksperiencës, për të tilla raste të ngjashme, përgjigjja nga kjo shoqëri ishte e njohur. Kur ka ndodhur vjedhja në objektin banesë, nga policia gjyqësore janë kryer verifikimet përkatëse për kamera në zonën përreth objektit banesë dhe nuk janë evidentuar të tilla. Në raportin e shërbimit të datës 21.12.2017 pasqyrohet se punonjësit e policisë, pasi kanë vëzhguar përreth pallatit për kamera sigurie, në rrugën “***”, si dhe në pallatet përballë tyre, kanë konstatuar se nuk ka pasur të instaluar kamera sigurie. Kërkesa e shtetasit I.Z për të administruar pamje filmike të kamerave të bizneseve në kryqëzimin afër banesës, nuk është

²⁶ Denoncim i shtetasit I.Z, regjistruar në Komision me nr. *** prot., datë 12.11.2018.

²⁷ Denoncim i shtetasës F.A, regjistruar me nr. *** prot., datë 18.2.2021.

marrë në vlerësim, sepse objekti banesë që është vjedhur, ndodhet në katin e tretë të një pallati, do të konsiderohej kërkesë e drejtë në rast se do të kishte kamera të instaluar në këtë pallat dhe jo në kryqëzimet e rrugës; për më tepër që edhe natyra e sendeve të vjedhura nuk mund të identifikonte ndonjë kalimtar në rrugë si autor të dyshuar të vjedhjes. Në lidhje me pretendimet e denoncuesit se prokurori ka kryer veprime të jashtëligjshme dhe jo sipas procedurës, që ka cenuar etikën dhe disiplinën e prokurorit, subjekti ka shtuar se të gjitha veprimet hetimore të mundshme janë kryer në zbatim të ligjit procedural-penal. Nga verifikimet e kryera pranë zyrës së regjistrimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë në regjistrin e çështjeve penale figuron vetëm shënimi që kjo çështje penale është e pezulluar.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

10.15 Pasi Komisioni administroi dosjen e procedimit penal nr. ***, regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në prapësime, konstatoi se nga ana e saj janë kryer të gjitha veprimet hetimore në përputhje me Kodin e Procedurës Penale. Subjekti ka demonstruar aftësi në lidhje me kryerjen e procedurave hetimore brenda afateve ligjore.

10.16 Në lidhje me denoncimin e shtetasës F.A, kjo shtetase pretendon se subjekti i rivlerësimit ka ndikuar në Prokurorinë në të cilën ajo ushtron detyrën për të mbyllur çështjen ndaj shtetasve E.L, bashkëshorti i subjektit dhe Xh.L, kunata, në lidhje me procedimin penal nr. *** për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 dhe 186/1 i Kodit Penal. Ky procedim penal rezultoi i pezulluar nga data 26.2.2014 nga prokurori A.D. Komisioni i kërkoi subjektin të rivlerësimit të japë shpjegime në lidhje me gjendjen aktuale të këtij procedimi penal.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

10.17 Subjekti në prapësimet e saj dhe në dokumentacionin e dërguar shpjegon se kjo çështje është e pezulluar.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

10.18 Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin në lidhje me këtë denoncim, konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë prokurore në kryerjen e hetimeve të kësaj çështjeje, gjë që mund ta vendoste atë në vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr. 96/2016. Gjithashtu, Komisioni nuk konstatoi ndonjë ndikim të ushtruar nga ana e subjektit të rivlerësimit ndaj kolegëve të saj në lidhje me hetimet e kësaj çështjeje.

Konkluzion i Komisionit lidhur me vlerësimin profesional

10.19 Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, denoncimeve të depozituara nga publiku, dosjeve penale të administruara në këtë kuadër, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale.

10.20 Trupi gjykues vlerëson se në bazë të hetimit të gjithanshëm që kreu në lidhje me vlerësimin profesional ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimin e relatores të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Eranda Laze:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, në bazë të nenit 51, shkronjës “a”, të pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash:

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Eranda Laze, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, aktualisht prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 8.11.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Xhensila PINE
Relatore (kundër)

Alma FASKAJ
Anëtare

Sekretare gjyqësore

Mevi Dibra

Analiza financiare

Peshkrimi	Deri 1.10.2004	1.10.2004-31.12.2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Pasuritë	-	5,000	43,724	35,617	64,455	5,356,569	720,616	5,826,220	182,991	78,093	204,969	(283,857)	(252)	22,888
Dy ap. banimi, të bashkuar në 1, në bashkëpronësi me b/shkëshortin me Ap. banimi në pronësi të b/shk tëm me sip.80m2,në Vlorë, 9.4.2008							5518,400	5,550,800			180,017			
Autonjet tip benz me targa AA***LF, blerë 30.6.2010 (VL ****D)								980,000						
Një shtëpi private banimi, (e amortizuar) dhe truall 200m2, Durrës - Tokë pyll e kultivë, me sip.500 m2, ***, Vlorë														
<i>Shtesa /pakësimë likuiditeteve</i>	-	5,000	43,724	35,617	64,455	5,356,569	(4,797,784)	(704,580)	182,991	78,093	24,953	(283,857)	(252)	22,888
Likuiditete në banka		5,000	48,724	84,341	148,797	1,309,891	7,582	3,001	85,992	164,085	289,058	5,181	4,929	27,816
Cash deklaruar DPV						4,195,475	700,000		100,000	100,000				
Gjendja e likuiditeteve	-	5,000	48,724	84,341	148,797	5,505,366	707,582	3,001	185,992	264,085	289,058	5,181	4,929	27,816
Detryme	-	-	-	-	-	(50,318)	(771,803)	3,405,223	(828,246)	(653,588)	(611,157)	(771,546)	(655,375)	(645,453)
Kredia NBG Bank sipas kontaktës 13.8.2008														
Pagesë kësti (Principali+interesi) nga 26.9.2008						(50,318)	(771,803)							
Kredia NBG Bank sipas kontaktës 11.1.2010								4,163,100						
Pagesë kësti (Principali+interesi)								(757,877)	(828,246)	(653,588)	(611,157)	(771,546)	(655,375)	(645,453)
Pasuri net (Pasuri - Detryme)	-	5,000	43,724	35,617	64,455	5,406,887	1,492,419	2,420,997	1,011,237	731,682	816,126	487,690	655,122	668,340
Të ardhurat	772,790	152,761	955,059	934,811	962,620	5,991,008	2,896,751	2,345,568	1,491,326	1,611,545	1,509,561	2,336,750	1,896,878	2,437,298
Të ardhurat nga paga subjekti	772,790	152,761	955,059	934,811	962,620	975,589	236,946	756,120	386,298	1,084,561	352,237	1,032,477	1,213,150	1,263,532
Të ardhurat nga kja e lindjes							304,432	112,448	327,196		454,579	102,385		
Të ardhurat nga paga e bish						88,119					384,921			
Të ardhura nga aktiviteti si avokat							1,680,000	1,477,000	777,832	526,984	17,824	1,201,800	683,728	1,173,766
Të ardhura nga trashëgimi-shtëpi e ap. 18 e 1,100,000														0
Të ardhura nga dhuratat për lindjen e Djalit											300,000			
Të ardhura nga loja ****											0			
Të ardhura nga loja ****											0			
Të ardhura nga interesat bankare							84,273							
Të ardhura nga diferenca e kursit të këmbimit							591,100							
Të ardhura nga bish para martesë						4,927,300								
Shpenzimet	187,911	23,491	129,557	178,557	230,120	198,223	614,603	550,648	907,589	913,846	977,264	1,349,202	1,375,200	1,804,794
Shpenzime jetike	187,911	23,491	109,557	109,557	136,620	170,775	364,320	409,860	523,710	558,192	658,112	1,099,990	1,121,580	1,175,460
Shpenzime udhëtimi						27,448	250,283	140,788	383,879	305,654	269,152	240,212	207,143	629,334
Shpenzime mobilimi										50,000	50,000			
Shpenzime qiraj			20,000	69,000	93,500									
Shpenzime ZRVP													46,677	
Shuma të shpenzuar sipas tërheqjeve bankare														
Mundësia për Kursime	584,880	124,270	781,778	720,637	668,045	385,898	789,729	-626,077	-427,500	-33,982	-283,829	499,859	-133,445	-35,836